

Kuvendi

Qarku

Arbjan Mazniku:

Atëherë, nderuar miq, nderuar anëtarë të komisionit, nderuar kryetarë të Bashkive të Qarkut Gjirokastrë, së pari ju falënderoj për prezencën. Jemi sot në ditën e dytë të dëgjimeve me kryetarët e bashkive nga qarqet përsa i përket reformës territoriale administrative. Kemi bërë javës që kaloi tre bashki, tre qarqe, dhe ka qenë një diskutim i gjatë që zgjati pothuajse gjithë ditën, për t'i shpjeguar kryetarëve pak a shumë siç është procesi për ata që s'e kanë ndjekur. Duke qenë se ne jemi në një situatë, në një fazë të dëgjimeve, synimi është që të marrim nga ju opinionin, mendimin tuaj në raport me të gjithë elementët e reformës, me kompetencat, me financat dhe territorin, dhe ndërlihdjen mes tyre. Ne kemi qenë në Zgjerë Kastër dhe ju keni qenë prezent në dëgjimin që ne bëmë me publikun, por ajo dëgjim që u bë në Zgjerë Kastër ishte e fokusuar, siç edhe e dëgjuat, më shumë te publiku si përfituesit e shërbimeve bashkiake. Kjo dëgjim e sotme fokusohet më shumë te ju si ofruesit e këtyre shërbimeve, si struktura të cilat janë përgjegjëse për të funksionuar, për të operuar bashkinë. Dhe ne jemi të interesuar të dimë për gjërat që kanë funksionuar mirë, për gjërat që s'kanë funksionuar mirë, si në raport me kompetencat, cili përgjegjësi apo kompetenca funksionon siç duhet dhe ju keni mundësi ta zbatoni në rregull, cili nuk funksionon siç duhet dhe ka problematika në mënyrën se si është deleguar, në qartësinë e delegimit të funksionit, në mekanizmat që ju keni në dorë për ta ushtruar funksionin, elementet që kanë të bëjnë me mënyrën se si është financuar funksioni apo si është financuar bashkia në tërësi, dhe së fundmi patjetër edhe elementët e territorit, pra si përket dhe si ndërlihdet madhësia e territorit që ju administroni në raport me mundësinë për t'i ofruar këto funksione dhe për të gjeneruar financat respektive. Ky është një ushtrim padyshim kompleks, por unë jam i bindur që zëri i kryetarëve të bashkive, si personat që e kanë këtë barrë në bazat përditshme, është në fakt një ndër burimet më të mira të informacionit për të kuptuar si mund të përmirësohet dhe të zgjidhet situata. Në çfarë është e rëndësishme të them është që ky komision ka një oportunitet i cili është shumë i madh për të pasur mundësi për të axhustuar dhe rregulluar jo vetëm elementët territorial, të cilët padyshim që kanë marrë një vëmendje shumë të madhe në diskursin publik të këtyre ditëve, është një gjë që njerëzit e kuptojnë thjesht dhe që lidhen ngushtësisht, por ne kemi mundësinë që të rregullojmë eventualisht apo të sistemojmë elementë që kanë të bëjnë me funksionet dhe përgjegjësitë që bashkitë kanë. Ndaj dhe unë jam shumë i interesuar posaçërisht për elementët që kanë të bëjnë në përgjithësi, si funksionon çështja e ndërtimit, si funksionon çështja e mirëmbajtjes së rrugëve, si funksionon çështja e shërbimit social, si funksionon çështja e funksionit, fjala qyteti, të pyjeve, e kontrollit të territorit, e mbledhjes së të ardhurave, elementë kyç që lidhen me mënyrën se si punon bashkia, pasi do të kemi mundësinë eventualisht që të ndikojmë dhe të sistemojmë dhe ato elementë ligjorë që ju japin mundësinë ju t'i ushtroni këto funksione. Ndaj dhe është e rëndësishme që të dëgjojmë nga ju problematika të këtyre fushave, që të kemi mundësi të shohim si mund të përmirësojmë eventualisht. Element tjetër kyç, prapë e them sërish, që ka nevojë për më shumë diskutim dhe teknik dhe praktik, lidhet me financimin, si financohet pushteti vendor, si funksionon raporti midis grantit që qeveria jep dhe të ardhurave që vetë bashkitë gjenerojnë, a ka hapësira ku

bashkitë mund të gjenerojnë më shumë të ardhura vetë, që ju i keni parë, i keni vlerësuar, a ka mënyra se si mund t'i fuqizojmë financiarisht bashkitë, duke rritur eventualisht dhe autonominë financiare që bashkitë kanë, si mund të funksionojë më mirë granti, përtej parimit thjesht që do ishte mirë të ishte më shumë, se këtë e dimë, kjo është e thjeshtë, po si mund të funksionojnë më mirë parimet e ekualizimit apo shqetësime të tjera të këtij teme që mund të jenë. Ndaj dhe doja të vendosja theksin posaçërisht te këto tema, sepse besoj që mund të na japin një kënd të mirë të identifikimit të problemit dhe zgjidhjeve, dhe padyshim që edhe tema që është më me shumë vëmendje që ka territori dhe ajo do të ketë vëmendjen e saj. Por unë do kërkoja në fakt nga të gjithë kolegët e deputetë që në respekt të kohës dhe të faktit që veçanërisht në Zgjerë Kastër kemi një numër të lartë bashkish, të kemi mundësinë që t'i mbajmë pyetjet e përmbledhura dhe t'i japim kohën kryetarëve për t'u përgjigjur. Ne kemi caktuar në mbledhjen e radhës një kohë për të pasur mundësi që ta limitojmë çështjen, ku kemi thënë që në qoftë se pyetjet janë komplekse, kryetarët kanë rreth tre minuta për t'u përgjigjur për secilën prej pyetjeve, që t'i japim kohë të gjithë. Dhe nëse janë pyetje më të thjeshta, ju kërkojmë informacion më të shkurtër, dy minuta. Për ta thjeshtuar kohën, kemi vendosur dhe një ekran që do të dali pas pak minutash kur të fillojnë pyetjet, bashkë me një orë për ta thjeshtuar kohën e përgatitjes dhe mundësisë që t'i japim të gjithëve që të flasin dhe të japin opinionin e tyre. Faleminderit.

Luçiano Boçi:

Nderuar kryetarë të bashkisë së Qarkut Zgjerë Kastër, nderuar deputetë, reforma që kemi ndërmarrë ka si qëllim përmirësimin e funksionalitetit të bashkive me fokus përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarit. Thënë me këtë përkufizim, qartazi janë dy aktorët kryesorë: është ofruesi ose dhënësi i shërbimit dhe marrësi i shërbimit. Në këtë rast, ofruesi jeni ju, bashkitë, ndërsa marrësi është qytetari. Në këtë lidhje, normal që qytetari është i pafajshëm, sepse është ai që blen shërbimin dhe është ai që pret që shërbimi ndaj tij të jetë sa më cilësor. Dëgjimet që kemi bërë në rang qarku na kanë shërbyer vërtet, por edhe kanë fshehur disa problematika, të cilat ne kemi menduar që mund të paraqiteshin përgjatë dëgjimeve, dhe në fakt më së shumti nga pjesa e maxhorancës ne kemi dëgjuar përfaqësuesit e institucioneve tuaja, që në përgjithësi nga ajo çka kanë shprehur janë shumë të kënaqur me situatën në të cilën operon pushteti vendor dhe në mënyrën se si operon dhe mënyrën se si ofron shërbimet e tij. Unë mendoj që kjo nuk përputhet plotësisht me të vërtetën. Patjetër që keni të drejtën që edhe këtu të deklamoni gjërat e mira që ju keni bërë, sepse s'kam dyshim që çdo kryetar bashkie, kur merr një detyrë, së pari mendon të shërbejë sa më mirë, por e rëndësishme është që përgjatë kësaj dëgjime ju të jeni në pozitën e kërkuesit. Nuk është një seancë dëgjimore hetimore. Duhet ta ndajmë që në fillim pozicionin. Vërtet, ne jemi opozita. Ndoshta kërkesa llogaritëse jonë ka tjetër tonalitet, por ajo synon një gjë shumë të mirë, që ne të marrim problematikën që ju i përjetoni si ofertues dhe ne t'i shndërrojmë pastaj në vendimmarrje me qëllim që të lehtësohet dhe të përmirësohet puna juaj atje ku ajo pengohet. Patjetër, në këtë debat hyjnë elementët si territori, kompetencat, funksionaliteti, funksionet, autonomia financiare, kompetencat që sot janë marrë dhe nuk funksionojnë, të cilat ju duhet t'i thoni, dhe shumë elementë të tjerë që lidhen sigurisht me territorin. Dhe territori është një territor i ndarë në mënyrë administrative sot, jo në mënyrë funksionale. Unë mendoj që këtu është një nga të metat e reformës së 2014-s, dhe kur territori ndërtohet gabim, pastaj shumë gjëra të tjera bëhen gabim, boshatiset, largohet qytetari, mungon përfaqësimi. Gjëra që sjellin pasoja në mënyrën si reagon qytetari. Sigurisht, reagimi i tij është instiktiv, nuk është se ai troket te dera e bashkisë dhe thotë: "Unë po largohem se ju si bashki nuk më keni ofruar një, dy, tre, katër, pesë gjëra", por kryen veprimin e tij dhe ne ndeshemi me një realitet

shumë të vrazhdë, me shpopullimin. Pjesë e madhe e popullsisë, sidomos Zgjerë Kastrë, mban rekord, është larguar nga territoret, dhe shkaku kryesor i largimit të njerëzve nga territoret është largësia me shërbimin, moskonsiderimi dhe mospërfaqësimi, dhe mosdhënia e shërbimeve, të disa shërbimeve, ose mosdhënia e cilësore e atyre shërbimeve që jepen. Në të gjithë këtë proces, sigurisht ka shumë probleme, dhe problemet lidhen me funksione të pashoqëruara me kompetenca, që pak a shumë janë shprehur nga ekspertët më së shumti. Ka funksione që nuk kanë mbulim financiar, sepse ka bashki që nuk kanë aftësi për të mbledhur shumë burime financiare nga taksat vendore dhe varen nga grantet, dhe ka funksione jo të qarta, sikurse ka kompetenca sulmuara nga qeveria me vendimmarrjet e saj, me ligjet e saj, VKM-të, ligjet godet edhe ligjin organik të pushtetit vendor, duke hyrë me dhunë, do thoja, fjalë domethënë shumë e rëndë, në pjesën e autoritetit të pushtetit vendor për shumë aspekte të funksionimit tuaj. Dhe duhet të jemi shumë të qartë në mënyrën se si e ndërtojmë dialogun, sepse ajo që kam vënë re përgjatë këtyre dëgjimeve, edhe me kryetarët e bashkive, është që insistohet dhe nga ju i mëshohet krahasimit të 2014-2015-s me 2005-ën. Nuk jemi këtu për të bërë krahasimin çfarë ishte bashkia, si funksiononin komunat para 2014-s, dhe sa bukur është bërë në 2014-ën. Këtu jemi për të ndërtuar ballafaqimin me 2014-ën dhe pritshmëritë që ajo ndërtoi, me qëllimet për të cilat u bë reforma e 2014-ës. Këtu duhet të fokusohet edhe debati ynë. Madje, unë po shkëputem për një moment, sepse nga komunikimi me ju për të thënë edhe një vërejtje që e kam për faqen e përbashkët të UEB-it në këtë pikë, sepse në këtë faqe që pasqyron punën e komisionit dhe mënyrën se si ne e konceptojmë reformën, është hedhur një tabelë që bën pikërisht një krahasim të tillë të funksioneve të para 2014-s dhe të post-2014-s, ndërkohë që ne qartazi e kemi përcaktuar që në objektivin tonë nuk është krahasimi fare, por është ajo çka duhet të përmirësojmë në atë që është bërë keq nga reforma e 2014-ës. Dhe për më tepër, tabela që ballafaqon funksionet nuk është e saktë në mënyrën se si i paraqet funksionet e reja dhe funksionet ekzistuese, sepse shumë funksione të paraqitura këtu kanë ekzistuar edhe para 2014-ës, por u formalizuan në ligjin organik në 2014-ën. Kjo është një vërejtje edhe për punën e komisionit tonë dhe për njerëzit që merren në mënyrë ekskluzive edhe me faqen UEB të pjesës së menaxhimit për atë çka komisioni jonë kërkon që të përcjellë në opinion. Dhe në qoftë se unë jam këtu dhe ne kemi vendosur si komision që para nesh të kemi kryetarët e bashkive, kjo është taksative. Ne duam këtu kryetarët e bashkive. Kryetarët e bashkive janë njerëzit që janë zgjedhur me votë direkte, janë njerëzit që kanë përgjegjësinë totale për të dhënë përgjigje për t'u përgjigjur para kësaj dëgjime në këtë komision parlamentar. Në qoftë se ju e bëni mot që këtu të vini me nënkryetar apo me administrator, atëherë dëgjimi është e dështuar. Dhe madje, në qoftë se këtu ka nënkryetar, se jo të gjithë i njoh vizualisht, atëherë unë kërkoj një ndërprerje pesë minuta, komisioni të kërkojë dhe të marrë një vendim që kjo situatë të mos përsëritet, dhe në qoftë se nuk janë kryetarët, seanca dëgjimore edhe mund të shtyhet. Është seancë dëgjimore me kryetarët e bashkive. Na ndodhi herën e kaluar, toleruam, sepse dy prej kryetarëve të bashkisë, të paktën nga Elbasani, qarku në Elbasanit, ishin në udhëtim jashtë shtetit. Dakord, shumë mirë, agjenda, por kalendari është përndarë kohë më përpara dhe është raportuar, kështu që dhe kryetarët e bashkive kanë pasur dijeninë e tyre. Prandaj, kërkoj zoti Mazniku një vendimmarrje shumë të qartë në raport me prezencën në komision të kryetarëve të bashkive. Mua nuk më duket serioze që ne të vijojmë të bëjmë dëgjime me nënkryetarët. S'ka asnjë lidhje pozicioni i nënkryetarit me pozicionin e kryetarit të bashkisë. Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Për pjesën e fundit, zoti Boçi, jam pjesërisht dakord me ju, me faktin që do të ishte shumë e udhës që ne të kishim këtu kryetarët, edhe unë i kam shprehur të njëjtin shqetësim si ju

kryetarëve të bashkive që nuk kanë pasur mundësi të jenë prezent. Siç edhe thashë në rastin e Elbasanit, ne mendoj që mund të shfrytëzojmë opsionin që në fund të dëgjimeve që po bëjmë me secilin prej qarqeve të ftojmë, t'i japim një mundësi kryetarëve të bashkive që për arsye agjende s'kanë qenë, por sidoqoftë mendoj që prezenca e nënkryetarëve, kur ne shkojmë të arsyeshëm dhe përmbledhim informacion për qytetin, jo për funksionin e kryetarit, është një gjë që e ndihmon çështjen, sepse nëse kemi një dhunë, një pyetje për qytetin, për çfarë funksionon, çfarë s'funksionon, çfarë është një gjë që shkon mirë, shkon mirë, besoj që marrja e opinionit nga nënkryetari nuk na prish punë. Sërish, po jam dakord me ju që dëgjimi duhet të jetë me kryetarët dhe me funksionin e kryetarit dhe me problemin e kryetarëve që ata kanë në detyrë, por nuk e shoh që na e pengon këtë objektiv prezenca e nënkryetarëve se mund të kenë një informacion për qytetin. Unë prapë mendoj që duhet t'i ruajmë vetes mundësinë që dhe për veten tonë si komision, por edhe kryetarëve të cilët për çështje agjende e kanë pasur të pamundur të jenë në datat që ne kemi kërkuar, të bëjmë një dëgjim në fund të dëgjimeve formale me ata kryetarë që s'kanë pasur mundësi të vijnë, por duhet të patur parasysh që koordinimi i agjendës midis deputetëve dhe të gjithë kryetarëve nuk e çon të dot të mundur në të gjitha rastet që të siguronim që të ishin të gjithë njerëzit. Do ta kemi këtë problem, ndonjëri do mungojë, se s'e puqim dot agjendën plotësisht.

Luçiano Boçi:

Atëherë, zoti Likaj, fjala për ju për procedurë.

Ramadan Likaj:

Para, unë bie dakord me bashkëkryetarin Boçi edhe me zotin Mazniku. Nuk mundet me kenë sot profesion në qoftë se ne themi që duhet të jenë kryetarë të bashkive, sigurisht që duhet të jenë kryetarë të bashkive në këtë dëgjim. Nuk mundet për me luajtur rolin një nënkryetar bashkie, rolin e kryetarit të bashkisë. Pse e them këtë? E them këtë si kryetar i bashkisë është asnjë zgjedhur. Nënkryetari i bashkisë është i emëruar. Ndaj them që në këtë pikë, si ish-kryetar bashkie flas, mos më keqkuptoni, nuk mundet një nënkryetar bashkie të marrë rolin e kryetarit të bashkisë. Ndaj them që në qoftë se ne duam me i dhënë seriozitetin e duhur këtyre dëgjimeve, unë mendoj që këtu u bë një tolerancë për kryetarin e bashkisë së Elbasanit dhe unë nuk mund të mendoj që ne të vazhdojmë me nënkryetarët e bashkive. Pse? Pyetjet tona janë drejtpërdrejt për kryetarin e bashkisë. Pra, besoj që jemi të qartë. Nuk kena asnjë lloj tentative negative për ju, u respektojmë, por pyetjet tona janë për kryetarët e bashkive. Faleminderit. Këtu thuhet qarku i Gjirokastrës.

Ramadan Likaj:

Zoti Qarku i Gjirokastrës, pra. Unë nuk thashë, nuk përmenda sa janë e sa nuk janë prezent, por nuk e thashë këtë, të lutem. Ne do u bëjmë pyetje kryetarëve të bashkisë, kaq.

Blendi Klosi:

Padyshim që ky është një nga seancat e komisionit, i cili ka një agjendë shumë të gjatë takimesh dhe unë e vlerësoj jashtëzakonisht shumë atë që ka ndodhur deri tani. Ne duhet t'ia njohim vetes këtë meritë këtij komisioni dhe meritë të dy bashkëkryetarëve që drejtojnë komisionin, që ja kemi dalë që në terren dhe të kemi dëgjime të vërteta me qytetarë, me funksionarë. Mbase mund të shikojmë një çik më shumë raportin nëse janë dëgjime

njerëzish që vijnë nga rruga apo njerëzish të ftuar nga partitë politike dhe mbajnë mbi vete më shumë opinion politik sesa opinionin e qytetarëve, por ama ngjarja ka ndodhur. Nuk besoj që mund të thuhet tani, mbas kaq kohe që punon komisioni, që këto dëgjime kanë munguar dhe kush ka pasur një opinion të përdhënë për reformën territoriale, nuk ka ardhur ta japë atë reformë. Në këtë kuadër janë dhe këto dëgjime që po bëjmë me kryetarët e bashkive, që prapë është në plotësim të një kërkesë të opozitës për ta bërë atë jo aty në terren, jo kur keni vajtur në Gjirokastër ta bëni këtë dëgjim në Gjirokastër. Mund ta kishim bërë dje në Durrës me kryetarët, s'kishim pse i merrnim veçantë kryetarët e bashkive këtu, por ama unë mendoj fort që duhet të shkojmë dakord. Nuk diskutohet që është një platformë politike komisioni dhe ne e humbasim, e humbasim shpesh raportin ndërmjet detyrës që kemi si anëtarë të komisionit me detyrën që si kemi si përfaqësues të forcave politike dhe vështirë të gjesh, domethënë, diskutim që janë jashtë politikës. Pra, ka një qëndrim Partia Demokratike që do të thotë që reforma e 2014-s ka qenë e dështuar dhe nga fillimi deri në fund e ka me këtë fjali, paçka se pastaj e kanë kuptuar dhe tani e kanë ndryshuar çikë atë diskursin dhe nuk thonë më është e dështuar, por është e mirë se nga 400 vajtëm në 61, po pse s'vajtën 100? Pse s'vajtën 70? Pra, le të themi që politika na shoqëron gjatë gjithë kohës. Tani, unë mendoj që ka momente që duhet të bëjmë edhe teknikun për të cilën ne jemi mbledhur këtu, që është dëgjimi i opinioneve që vjen nga pushteti vendor për mënyrën si funksionon dhe shumë mirë që kjo punë po bëhet e veçantë dhe besoj e kuptojmë të gjithë që këtu jemi në fazën, le të themi, të dytë apo të tretë të diskutimit. Nuk mund të diskutosh me kryetarët e bashkive apo me përfaqësuesit e kryetarëve të bashkive për territorin, po natyrisht do të diskutosh për kompetencat, për ato çfarë kryetarët e bashkive kuptojnë në funksionimin e tyre ditor për financat, për procedurat, për funksionet që ata kanë. Pra, dhe ta kthesh prapë këtë bisedë nëse janë kryetarët apo nënkryetarët dhe meqënëse zoti Likaj edhe e vlerësoj shumë ndërhyrjen e tij, vjen edhe si ish-kryetar i bashkie, mbase këto gjëra i di shumë më mirë nënkryetari sesa kryetari. Ne këtu jemi për të dëgjuar opinionin e përfaqësuesve të zgjedhur dhe e kuptoj që nuk ka pse të mos jetë një funksionar o kryetar, o nënkryetar, po ne edhe mbledhjet e komisionit i bëjmë me zëvendësministra. Pra, ne na duhet qëndrimi i institucionit, nuk na duhet debati me kryetarin e bashkisë së Tepelenës që e kemi këtu apo kryetarin e bashkisë së Dropullit që e kemi këtu dhe nënkryetarët që i kemi po prapë këtu. Prandaj, ne duam të bëjmë punën apo duam të bëjmë politikën? Politikën padyshim do ta bëjmë gjithmonë. Ne nuk mund t'ia heqim njëri-tjetrit dimensionin politik, por ama nuk e nxjerr dot nëse është e dështuar ose jo reforma e 2014-s, duke thënë që pse s'kanë ardhur kryetarët, por kanë ardhur nënkryetarët. Ne t'i pyesim për problematikat që ne mendojmë që janë në funksionet e tyre dhe të vazhdojmë. Në qoftë se doni opinionin tim, në Shqipëri janë bërë shumë reforma në këto 12 vjet. Kryer reforma është reforma e 2014-s edhe shumë mirë kemi bërë që ia kemi hequr vetes të drejtën që të flasim nëpër takimet publike, se aty t'ia lëmë njerëzve, qytetarëve, përfaqësuesve për t'u shprehur. Por në qoftë se doni, hajde bëjmë dhe këtu një debat, e lëmë një ditë, bëjmë një debat mes njëri-tjetrit për reformën, se çfarë do të thotë që tani Durrësi është më i madh, çfarë do të thotë që tani Tepelena është më e madhe, çfarë do të thotë që tani Dropulli është më i madh, çfarë do të thotë tani që Shkodra është më e madhe, çfarë do të thotë shërbimet ka qytetarëve, çfarë do të thotë reformat që janë ndërmarrë, çfarë do të thotë strukturat, çfarë do të thotë funksionet, çfarë do të thotë shërbimet, çfarë do të thotë investimet. Edhe le ta bëjmë këtë debat një ditë, t'ia heqim vetes këtë dëshirën për të folur, po ama ta bëjmë edhe debat tani. Kanë ardhur përfaqësues të institucioneve, ashtu siç ne e kemi normë në fakt në jetën tonë parlamentare, ministër ose zëvendësministër, edhe ta vazhdojmë këtë bisedë. Ta vazhdojmë. Kemi bërë një gjë shumë të madhe për politikën shqiptare. Na e kanë thënë nëpër takimet që kemi bërë. Mbas 35 vjetësh kemi arritur të ndajmë sallat PS, PD dhe siç ishte dhe debati dje në Durrës, tre orë pati nuanca politike, por nuk pati, le të themi,

mosrespekt për krahët e sallës. Kështu që t'ia ruajmë vetes këtë dëgjim të mirë që i kemi arritur. Këtë e kisha ndërhyrjen time.

Luçiano Boçi:

Po atëherë kam unë vetë një ndërhyrje. Së pari, askush këtu nga folësit, të paktën unë dhe zoti Likaj, nuk dolëm në konkluzionin siç dolët ju si folës që ka dështuar, sepse reforma po edhe unë folës e quajta veten se folës jemi tashti. Po nuk, po mirë, po e tërheq folës anëtar komisioni. Thashë folëm dhe folës ruajta atë vazhdimësinë gjuhësore në këtë rast dhe faleminderit për komplimentat. Edhe unë po, po jo se mund të marrësh dhe ti komplimenta nga ana ime. Prit, mos u tregoj i padurueshëm dhe asnjë nga ne nuk dolëm në konkluzionin që ka dështuar reforma, se këtu kemi nënkryetarët e bashkive, as në mënyrë drejtpërdrejtë, as në kontekst. Nuk u tha kjo gjë fare dhe ndërkohë ne nuk kemi modifikuar asgjë nga qëndrimi ynë në raport me këndvështrimin ndaj reformës territoriale që ka dështuar 2014-a. Kjo është e qartë, nuk e thotë Partia Demokratike. E thonë raportet e institucioneve ndërkombëtare, thotë UNDP-ja, thotë Banka Botërore, e thonë shumë raporte edhe kombëtare në lidhje me atë çka ka prodhuar dhe produkti më tronditës është humbja e popullsisë, jo lëvizje migratore, por lëvizje emigratore, sikurse mungesa e përfaqësimit që është ngritur nga qytetarët dhe distanca e madhe e shërbimeve, sikurse dhe mungesa e shërbimeve. Dhe gjithsesi këto gjëra ne jemi duke i shqyrtuar, por që duhet të jemi shumë të qartë në qëndrimet tona. Në raport me atë çka u ngrit dhe në fakt çka duhet të diskutojmë së bashku sot është që duhet të vijojmë që ta konkretizojmë dhe mos dalin parashikime të gjata politike. Duhet të vijojmë me nënkryetarët apo na duhen vetëm kryetarët? Funkionarët, edhe këtu u tha edhe nga ju që i paskemi dëgjuar në dëgjimet publike edhe dje në Durrës. Dëgjuam ne kryetarë të këshillit bashkiak, nënkryetarë të këshillit bashkiak, administratorë. I dëgjuam funksionarët dhe nënkryetari është funksionar. Janë ngritur edhe nënkryetarë në dëgjimet tona. Në komision ne kemi vendosur që të thërrasim kryetarët e bashkive të qarqeve. Nuk e kemi këtë se duam patjetër t'i sjellim nga territoret e tyre, t'i marrim me zor edhe të vijmë këtu në Tiranë. Thashë, unë e parashtrova shumë qartazi, nuk është komision hetimor, është bashkëbisedim shumë i vërtetë dhe i sqartë, duke e parë njëri-tjetrin në sy. Duam prej jush atë gjë që nuk shkon, që ju nuk e bëni dot, atë funksion që nuk e realizoni se ju mungon kompetenca, atë funksion që nuk e realizoni se ju mungojnë burimet financiare, atë funksion që nuk e bëni sepse nuk keni administratën e duhur dhe kjo administratë duhet përmirësuar dhe jo duhet shtuar thjesht numër siç është dyfishuar apo trefishuar. Ne duam ato problematika. Doni të thoni gjëra që janë bërë mirë? Po mund t'i thoni. Thashë, ne do bëjmë pyetjet tona dhe ajo që kërkoj unë është që t'i qëndrojmë korrekt dhe njëri-tjetrit. Nuk jemi këtu për të nxjerrë në pa që ju keni punuar keq dhe do ju dëgjojë ai votuesi dhe nesër s'do ju votojë. Jo fare. Ne jemi këtu për t'ju ndihmuar dhe për të ndihmuar punën e komisionit në fakt. Në shumë gjëra ju duart i keni të lidhura. Nuk e bëni këtë sepse nuk e bëni atë sepse, po këtu nuk e thoni dhe nuk e transmetoni për atë arsyen e paragjykitimit të votës apo të gjykimit që do ju japi vetë votuesi. Por në fakt s'duhet këndvështruar kështu dhe meqënëse është ky parashtrim, këtë gjë më mirë në gjykimin tonë edhe të komisionit, siç e kemi vendosur, e thotë kryetari i bashkisë dhe që mos kemi shumë debate, e bëjmë si në rastin e Elbasanit. Po, kemi rënë dakord që Elbasani dhe Gramshi të vijmë në një moment tjetër dhe ne këtë po kërkojmë. Janë katër këtu kryetarë bashkish. Shumë mirë. Të vazhdojmë me katër kryetarë bashkish dhe dy të tjerë që nuk janë të vijmë në kohën që do të jetë Elbasani. Mund të kemi dhe kryetarë bashkisë që nuk do vijmë në dëgjimet, dy dëgjimet e tjera që kemi planifikuar. Do lëmë një ditë pastaj që t'i grupojmë ata dhe të vazhdojmë. Unë kështu mendoj dhe ky është propozimi im dhe është shumë i qartë.

Arbjan Mazniku:

Jam shumë dakord me gjithë propozimin tuaj. Diferenca vetëm e dispozimit tuaj dhe timit është që nënkryetarët që kanë marrë rrugën kanë ardhur. T'i mbajmë dëgjimet. Nëse kemi një pyetje ku na intereson përgjigja e qytetit respektiv, që është informacion teknik që ata mund ta kenë, ne s'e dëgjojmë, s'na prishet si punë. Në qoftë se, por ama, nëse s'na bën punë, nuk i bëjmë pyetje këtyre dhe do ta bëjmë, do ta ruajmë opsionin që kryetarët e bashkive që nuk kanë ardhur të jenë të ftuar një tjetër. Po sot, se e morëm informacionin nga teknik administrativ, nga personat që janë përgjegjës, nëse na duhet për të krijuar imazhin tonë për problematikën nga vendi respektiv sot, s'na prish asnjë punë, them unë. Pra, parimi që kam është që po, ke të drejtë, po do ecim me atë parim, por ti, meqënëse i kemi këtu nënkryetarët, kur kemi një pyetje teknike për atë rast, do ta pyesim nëse e kemi informacionin, nëse e marrim përgjigjen mirë, nëse s'e marrim.

Luçiano Boçi:

Po, nuk thashë që t'i përzemërsojmë, se nuk është as njerëzore edhe as etike fare. Nuk e thashë në këtë aspekt. Këtë pjesën e ndërhyrjeve teknike, po normale, e pranojmë, por të mos ta konsiderojmë që ne kemi realizuar dëgjimin me bashkinë. Kjo është themelore, se normal kanë ardhur, janë ulur aty dhe, domethënë, do ishte abuzive nga ana jonë të kërkosh një gjë të tillë. Fare s'e artikulovala. Po, a mund të vazhdojmë?

Arbjan Mazniku:

Vazhdojmë. Jam dakord të fillojmë me pyetjet. Atëherë fillojmë me pyetjet. Kush nga zoti Elezi?

Ermal Elezi:

Doni ju? Nuk respektojmë, nuk ka ndonjë... Faleminderit kryetar për prezencën. Në lidhje me qarkun Gjirokastër, bazuar dhe në raportet që janë përgatitur qoftë nga donatorët, qoftë nga mbështetja e donatorëve për sa i përket performancës, ka dy konkluzione që do të doja të ndaja me ju që kanë të bëjnë: një, i pari është një lloj korrelacioni të qartë midis madhësisë së bashkisë dhe aftësisë për të ushtruar funksionet, dhe korrelacioni i dytë ka të bëjë që bashkitë 90 mijë banorë kanë varësi shumë më të madhe nga transferta qeveritare. Thënë këto dy premisa, duke qenë se bashkitë që ju përfaqësoni kanë qoftë kriterin që nuk janë, nuk hyjnë te bashkitë mesatare, po i quajmë OSP të mëdhaja dhe hasin vështirësi ndoshta me këto funksione, do të doja të kuptoja cilat janë këto funksione. Dhe gjithashtu, për sa i përket të ardhurave, që qartazi, duke u mbështetur vetëm te transferta, nuk krijon premisa për autonomi financiare, do të dëshiroja mendimin tuaj për sa i përket mundësisë, duke diversifikuar burimin e të ardhurave, dhe në ç'gjendje ka kapacitet bashkitë tuaja për të zhvilluar kompetenca për sa i përket vjeljes së të ardhurave, kur është e mundur, për të rritur projekte të zhvillimit ekonomik dhe projekte të Bashkimit Europian, duke pyetur specifikisht kapacitetet teknike dhe administrative që kanë bashkitë për të realizuar projekte të tilla. Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit. Atëherë, duke qenë se ishte një pyetje e drejtuar të gjithë kryetarëve, unë do të thoja që të shkojmë me radhë tek kryetarët që duan se mendoj që të përgjigjen për këtë pyetje me radhë, nga si ta mendoni, qoftë nga Leonardi, nga Alberti, qoftë nga ana tjetër. Po të përgjigjet secili.

Leonard Hide:

Atëherë, përshëndetje dhe më vjen mirë që na u dha rasti që të dëgjohe mi. Dhe do të thoja që në radhë të parë, ne kemi ardhur si vërtetë si jemi të zgjedhur të atij komuniteti dhe kemi ardhur për të përçuar zërin e atij komuniteti. Për çfarë doja që të transmetoja tek ju dhe të thoja që është pjesa e fjalës së ditës që është bërë tek banorët. Fokusi është drejtuar dhe gjithë njerëzit pyesin: pyetja është a do të ekzistojmë si bashki apo jo? Ne kemi ardhur këtu. Unë personalisht kam ardhur vërtetë si drejtues, por dua t'ju drejtoj edhe si një qytetar i asaj zone, asaj treve. Pavarësisht, vështirësitë financiare janë. Jemi në grupin e bashkive të vogla me një territor shtrirje të madhe. Ato çfarë kemi parë, problematika është që ne e kemi diskutuar edhe në takimet e parshme kur zoti Masniku ka qenë ministër i pushtetit, ku kemi parë që nevoja ishte e trajnimit të stafëve. Gjë që do të na çojë më përpara edhe për të vënë në shërbim të komunitetit dhe për të zgjidhur gjithë ato probleme që kanë. Do të thoja se ky diskutim do të doja që të ishte thjesht teknik për pjesën e numrash apo pjesë buxhetesh. Në qoftë se kemi më pak njerëz, ose në qoftë se njerëzit vazhdojnë që të lëvizin, do të thotë që kemi nevojë për më shumë mbështetje. Do të thotë që kemi nevojë për më shumë investime. Do të thotë që kemi nevojë për më shumë vëmendje. Nuk na ka munguar, por vlen dhe është e arsyeshme që të ketë më shumë akoma.

Dhimitraq Toli:

Zoti Toli. Përshëndetje të gjithëve, të nderuar anëtarë, të nderuar kryetar. Gjatë procesit të reformave të kësaj natyre, siç është reforma administrative ose territoriale, e cila ka impakt të gjerë dhe shtrirje kohore të konsiderueshme, duhen marrë patjetër në konsideratë edhe faktorë të tjerë, sidomos për bashki me specifika të veçanta, siç është bashkia Dropull, e cila përbëhet nga banorë që i përkasin pakicës kombëtare greke. Në bazë të detyrimeve që lindin nga aderimi i Republikës së Shqipërisë në Konventën Kuadër të Mbrojtjes së Pakicave Kombëtare të Këshillit të Europës neni 16, si dhe Ligjit 96 të 2017-s për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë, vlerësojmë se duhet marrë në konsideratë mundësia e lënies së bashkisë Dropull si bashki më vete, sipas statusit që gëzon aktualisht. Në këtë mënyrë sigurohet gëzimi optimal i të drejtave të pakicave, i cili shpeshherë lidhet me kritere numerike. Plotësimi i këtyre kriterëve, në rast të një ndryshimi eventual, do të vështirësohej fakt, i cili do të cënonte gëzimin e këtyre të drejtave, të cilat përbëjnë element bazë të parimeve të gjithëpranuara demokratike të shtetit të së drejtës. Vlerësojmë se madhësia aktuale e bashkisë Dropull është në kushtet optimale për të ruajtur ekuilibrin nëpërmjet ofrimit efektiv të shërbimeve drejt qytetarëve dhe përfaqësimit real të mbrojtjes së të drejtave të pakicave. Tani, për burimet financiare, burimet financiare të bashkive me funksione dhe përgjegjësitë që ato mbajnë, sot nuk përputhen plotësisht. Funksione specifike që janë transferuar në bashki, siç janë shërbimi pijor, kullimi, rrugët rurale, arsimiti parashkollor e të tjera, nuk mbulohen plotësisht me fonde nga transfertat e pakushtëzuar. Bashkia, për ofrimin e shërbimeve për këto funksione, krijon shpenzime të cilat detyrimisht i shpenzon nga të ardhurat e bashkisë dhe përsërit janë të pamjaftueshme. Çfarë duhet të rishikuar më parë? Të ardhurat vendore, formula e transfertës së pakushtëzuar, barazimi fiskal apo instrumentet e financimit për investimet? Faleminderit. Faleminderit.

Gramoz Sako:

Përshëndetje. Të nderuar deputetë, falenderoj komisionin për këtë dëgjim konsultativ mbi reformën administrative territoriale. Një debat, i besoj, duhet të jetë më shumë i gjerë sesa debati politik, një thjesht numri i bashkive apo rivizatimin e artës së Shqipërisë nga

pikëpamja e kufijve bashkiakë. Nga provoja në terren, megjithëse unë jam ndër kryetarët me kohën më të shkurtër në detyrë, problemi kryesor vlerësoj që nuk është nëse bashkitë janë shumë apo pak, numri i bashkive. Problemi janë kompetencat e pamjaftueshme që ne kemi. Qytetari vazhdon të shohë deri në bashki si adresën ku kërkon çdo lloj zgjidhje, por kryetari i bashkisë shpesh nuk ka instrumentet dhe autoritetin për t'i dhënë zgjidhje problemeve. Ndeshemi për të njëjtat probleme që janë kudo: me rrugë, me ujë, për nevoja për energji elektrike. Të gjitha këto, jo vetëm që qytetari i kërkon te dera e kryetarit të bashkisë, dhe si drejtues vendor nuk mundem t'ju jap përgjigje dhe zgjidhje të gjitha problemeve. Ndaj mendoj se reforma duhet të ketë fokus sipas meje, jo ndarjen apo bashkimin, por shtimin e kompetencave, fuqisë së vendimmarrjes në nivel vendor. Dhe këtë nuk dua t'ju ul aspak vlerën punës së bërë nga ana juaj, të nderuar, por në gjithë këtë javë, padyshim që vjella e opinionit të ekspertëve, drejtuesve, zërave vendor, banorëve do të ndihmojë në hartimin e një dokumenti që të rezistojë kohës. Sa më tepër t'i afrohem familjes europiane, ku decentralizimi është një parim bazë, aq më tepër do të vrente që bashkitë të kenë mundësi për ndërhyrje energjike për shërbime jetike për komunitetin. Tepelena, për shembull, po hyn në artën e bashkive turistike për vite më tepër dhe ajo do të ndihmojë, do të ndihmonte në zhvillimin e një sektori, do të ishte zgjerimi i portofolit të investimeve publike dhe nga burimet e saj. Ne jemi një bashki që mbledhim 90% të taksave, por prapë nuk mjaftojnë ato për të bërë investime, apo kështu që varem nga fondet e qeverisë, nga fondi i pakushtëzuar. Të gjitha ato që tha, pjesën e financimit që tha zoti Tola, zoti Toli vlejné dhe për bashkinë e Tepelenës. Vendi i duhet një pushtet lokal më i fortë me përgjegjësi përballë qytetarëve, se ne u trokasim të gjithëve në derë për të kërkuar votën dhe shpesh gjendemi pa mundësi për të zgjidhur problematikat që ofron shërbimi që meritojnë. Shumë faleminderit. Faleminderit, zoti Malaj.

Albert Malaj:

Përshëndetje të gjithëve. Faleminderit për krijimin e mundësive që na jepni për t'u shprehur zërin e qytetarëve. Bashkia me Malia e shpreh mosdakordësimin e saj ndaj skenarëve të propozuar për riorganizimin territorial të bashkive, nëse do t'i referoheshim skenarit të parë që parashikon bashkimin e bashkive të vogla me bashki fqinje më të mëdha, më të fuqishme, mund të themi se ky nuk është rasti për bashkinë me Maliaj. Bashkia me Maliaj është një ndër bashkitë më të mëdha në qarkun e Gjirokastrës, si nga sipërfaqja territoriale dhe nga popullsia. Bashkimi i bashkisë me Maliaj me një bashki fqinje mund të ishte një rrezik real që bashkia me Maliaj të humbasë identitetin dhe zërin e saj në vendimmarrje, duke e lënë në nevoja, duke e lënë nevojat e saj në hije dhe problemet e saj asnjëherë nuk do të marrin vëmendjen e duhur. Qytetarët tanë kanë probleme dhe prioritete specifike që nuk duhet të zbehen nga interesat e zonave më të mëdha. Së dyti, ideja e krijimit të bashkive më të mëdha në nivel ish-rrethesh, megjithëse paraqitet si decentralizim, në fakt mund të sjellë një distancim të mëtejshëm të administratës nga qytetarët. Sa më e madhe të jetë njësi administrative, aq më e vështirë bëhet komunikimi dhe adresimi i drejtpërdrejtë i shqetësimeve lokale. Dhe në rastin e bashkisë me Maliaj, me 53 fshatra, pjesa më e madhe e të cilave janë të shpërndara në zona të thella. Zbatimi i kësaj reforme do të shkaktonte pabarazi zhvillim dhe rrezikim e mungesës së shërbimeve ndaj komunitetit. Nëse do të ndalshim tek skenari i tretë i propozuar për reformën territoriale, forcimi i rolit të qarkut si një nivel i fuqishëm ekzekutiv rrezikon të dobësojë autonominë e bashkive. Nëse kompetencat kalojnë në një nivel më të lartë, atëherë vendimmarrja nga komuniteti mund të bëhet dhe më burokratike. Ne besojmë se vendimet që prekin qytetarët duhet të merren sa më pranë tyre dhe duhet t'i përkasin bashkive. Së fundi, skenari i rajoneve strategjike, edhe pse synon zhvillimin e infrastrukturës të fortë, në këtë rast bashkia me Maliaj mund të mos përfitojë në mënyrë

të barabartë, pasi prioritetet mund të kenë zonat më të mëdha dhe më të zhvilluara. Bashkia me Maliaj është në mbrojtje të një parimi thelbësor, siç është qeverisja sa më pranë qytetarëve, e drejtë në përfaqësim dhe e balancuar në zhvillim. Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Po, zoti Elezi, një koment se që e lamë përpara pyetjes së radhës.

Ermal Elezi:

Çështja, çështja është që pak a shumë ato që unë shtrova ishin dy problematika që janë fakte. Pastaj, domethënë, parimet ose zgjidhjet i keni secili në liri. Që, domethënë, në rastin konkret, bashkia Libohovë dhe me Maliaj kanë përkatësisht 5% me Maliaj.

5% me Malli të ardhurat e veta, pra autonomi fiskale, 6% e Kali Bohova, që do të thotë 95% dhe 94% janë transfertë. Tani, ky është fakti. Përballë këtij fakti, unë prandaj e thashë: kjo ndodh zakonisht në bashkitë më të vogla. Pastaj, fenomeni pse ndodh mund të bëhet një analizë e gjatë. Çështja që doja ta lidhja është: ekzistojnë kapacitetet, pikë së pari, që ju të zhvilloni diversifikim për të rritur të ardhurat, dhe kur thashë për diversifikim, është: ne këtë proces dhe këtë reformë po e bëjmë edhe në kuadër të rritjes së kapaciteteve për Bashkimin Europian. Dhe duhen kapacitete për të arritur për të bërë projekte, sepse nëse shkojmë në një vend tonë fqinj anëtar, siç është për shembull dhe vetë Greqia, do shohim që shumë nga të ardhurat që i vijnë bashkive janë nga programet e Bashkimit Europian. Dhe përballë këtyre sfidave, që pavarësisht mund të jetë sa është potenciali brenda vetë, është çështja: a ka mundësi bashkitë tuaja të zhvillohen më tej, apo do rrinë të presin nëse transfertat rritet, që do rritet dhe kjo përqindje, dhe thjesht do jepni kontribut 1% dhe do të shkojë, fjala vjen, në 99%? Dhe duhet të kuptoj kapacitetet administrative në vend për të ushtruar funksione. Jo çështjen pastaj, e kuptoj këtë pjesën se dëgjova dhe kryetarin, mund patjetër të diskutojmë për kompetencat, se kompetencat shumë mirë janë, po nëse nuk ushtrojmë siç duhet në bashkitë e vogla dhe funksionet që kemi, nuk e di se ku mund të na çojë me kompetencat e tjera. Ky ishte në thelb shqetësimi im. Mora disi përgjigje, por do të doja të kuptoja vizionin se si mund të adresohet kjo problematikë vënë përballë këtij fakti.

Arbjan Mazniku:

Okej. Po.

Bashkia Gjirokastrë (Artiste Koko):

Përshëndetje të gjithëve. Faleminderit për mundësinë që më dhatë për të dëgjuar. Megjithëse u diskutua shumë për përfaqësinë tonë, unë jam artist e koko Bashkia Gjirokastrë, nënkryetare dhe njëkohësisht nëpunës i autorizuar, i deleguar. Pyetjet që u bënë rezultuan që të ishin teknike, dhe kjo më jep të drejtën që të shpreh gjithë opinionin si specialist, mbase jo si në kuadrin e politikëbërjes, por reforma territoriale nuk duhet të shikohet si reformë si hartë, por duhet të shikohet cilat ishin ato problematika që ne i hasim sot në ushtrimin e funksioneve. Një nga problematikat që solli reforma territoriale ishte se bashkive iu bashkuan funksionet nga ish-komunat dhe të pakostuara për shërbimin. Iu bashkuan bashkive dhe bashkitë ishin të detyruara t'i ushtronin këto funksione pa fond, pa fonde të mjaftueshme për t'i ofruar këto funksione. Duke u ndodhur para këtij fakti, ishte detyruar të rriste tarifën ndaj qytetarëve, të ushtronte presionin e rritjes së tarifave për të

ushtruar funksionin. Por kjo nuk ishte një nga efektet negative të reformës territoriale të 2015-s. Ajo çfarë i dhamë bashkive është mënyra e standarte e planifikimit, menaxhimit dhe mbledhjes së të ardhurave. Bashkia Gjirokastrë ka 35% deri në 40% autonomi fiskale. Kjo vjen për faktin sepse burimet njerëzore duhet të përmirësohen. Të gjitha bashkitë duhet në fillim të flasin një gjuhë për të ardhurat vendore. Asnjë nga bashkitë nuk e ka një sistem të dixhitalizuar të të ardhurave që të flasim një gjuhë, të kemi krahasim midis të ardhurave dhe të shikojmë potencialin e secilës bashki për të rritur bazën e taksueshme. Në mendimin tim, pavarësinë, autonominë bashkisë ia jep planifikimi, menaxhimi, administrimi, mbledhja e të ardhurave vendore. Kemi akoma varësi nga transfertat e pakushtëzuar. Nuk mundemi sot, në 2025, në 2026, të flasim për grantet e transferuara mbi kriteret e numrit të popullsisë. Popullsia mund të jetë në të kurrje, por territori është po ai, shërbimet janë po ato. Nuk mundemi të adresojmë gjithë problematikën që qytetari ishte i papërfaqësuar. I gjithë kuadri ligjor, duke nisur që nga ligji organik i vetëqeverisjes vendore të 2015-s, të përmirësuar, domosdoshmëria e përfaqësimit të qytetarit është duke u rritur. Jo vetëm tek ligji organik për funksionimin e pushtetit vendor, por edhe tek ligji organik për menaxhimin e financave vendore, të cilat duhet të rishikohen. Ky është problemi thelbësor i autonomisë së pushtetit vendor. Nuk mund të flasim për territore dhe për harta pa fuqizuar bashkitë, financat e tyre, burimet njerëzore, që nuk mund t'i gjejmë shumë bashki. Specialistët e fushave të ndryshme janë të detyruar t'i marrin nga bashki të tjera. Ka funksione me mbivendosje kompetencash? Po, ka funksione me mbivendosje kompetencash, dhe pikërisht këto mbivendosje kompetencash sjellin problemin e bashkisë për mundësinë e zhvillimit të tyre ekonomik. Ekziston ligji për zhvillimin ekonomik për të gjitha kompetencat, por ka kompetenca si ujitja dhe kullimi që mirëmbajtjen e tyre e bën dhe ka kosto bashkia, ndërkohë që politikat për zhvillimin e bujqësisë e bën pushteti qendror. Bashkitë kanë bërë çmos që të zhvillohet sistemi rural, ka zhvillim të turizmit rural, ka zhvillim të infrastrukturës rurale, por duhen rritur autoriteti dhe duhet të rritur forca e bashkisë për të fuqizuar këto shërbime. Nuk është problemi i distancës territoriale, por është problemi i fuqizimit të bashkive që të ofrojnë shërbime. Bashkia Gjirokastrë menaxhon 19 projekte me financim të huaj, që nuk do të mendohej më përpara nëse bashkitë, ish-komunat, duhet apo kishin. Sot, një pjesë e konsiderueshme të të ardhurave të bashkisë, të buxhetit të bashkisë, janë edhe fondet e huaja. Ishim me një sektor dhe u bëmë me një drejtori që është pothuajse njësoj si drejtorja e urbanistikës që menaxhon projektet e huaja. Kemi nevojë të na jepet kompetencë dhe bashkive t'u jepet kompetencë e plotë për funksionet që kanë mbivendosje me pushtetin qendror. Faleminderit.

Luçiano Boçi:

Po, faleminderit, një shtesë. Po, të bëj një shtesë të vogël, Mal, për pa hyrë në polemikë me zotin Elezi, por duke ndihmuar pak parashtrimet e kryetarëve të bashkive që konsiderohen të vogla, po, është e vërtetë që nuk kanë mundësi që të sigurojnë të ardhura nga mbledhja e taksave dhe janë varur nga transfertat e kushtëzuara dhe e pakushtëzuar. Dhe po, nuk kanë administratë e cila të jetë kaq e përgatitur sa t'i përgjigjet të gjitha sfidave që kanë sot bashkitë, por këto nuk janë argumente për t'i thënë atyre që nuk do ekzistonin. Ky është qëllimi i komisionit që të përmirësojë këtë marrëdhënie. Jo, ta nënkuptojmë se ishte. Po jo se bëra polemikë, se e kam me ju, zoti Elezi. E kam, s'dua të... Po mirë, ju referova në komunikimin me... Domethënë, unë ju referova duke thënë që po, është e vërtetë. Po, është e vërtetë, unë nuk thashë që s'keni të drejtë, por ne jemi përgjetur zgjidhjet për këto dështime, se dalin pastaj që ka dështuar apo jo, por s'dua të hyj në debat politik. Dhe zgjidhjet janë disa, sepse nuk ka kapacitete administrative. Po, ekziston bashkëpunimi ndërbashkiak. Është një nga funksionet e shtuara këtu në ajo tabela që ju referova unë, që duhet hequr në fakt. Dhe bashkëpunimi ndërbashkiak i lejon Libohovës

apo me Malli që të ndihmohet nga Gjirokastra, se paska kapacitete Gjirokastra, dhe ky bashkëpunim në rang qarku nuk e bën të nevojshme që kapacitetet administrative të Malli dhe Libohovës të jenë në lartësinë e Gjirokastrës. Një mënyrë. Mënyra tjetër është me prokurim, siç bëhet. Me prokurim, sepse projektet e juaja marrin vido në një zyrë këtu në Tiranë. Po s'kalon nga ajo zyrë, apo jo? Ja dhe paguani nga ajo zyrë ju. Po pra, më fal, e dimë këtë gjë. E dimë se... Ja pra, ja pra ku është rruga, kanalizimi, si kalohen pastaj, si kalohen nëpërmjet asaj zyre. E di dhe zyrën, nuk ka rëndësi, se s'do marrim në gojë zyrën këtu, nuk kemi për këtë gjë, jemi për mënyrën si funksionon. Dhe pjesa tjetër, që t'i themi atyre që janë vegjël, që ne do gjejmë mekanizmat që ju të ofroni shërbim për qytetarët, jo të ekzistoni ju, se do ishte e gabuar këndvështrimi që të ekzistoni ju. Jo, që të ofroni shërbimin e duhur për qytetarët që jetojnë në ato territore. Dhe kush është? Është modeli, pra modeli i financimit. Modeli ose gjerman, sot është 1% e produktit të përgjithshëm bruto, madje është 0.9%. 0.09%, sepse ka rënë. Dhe ta bëjmë 10%, jo 14%. Transferta e pakushtëzuar të jetë e madhe dhe ai ka mundësi si bashki e vogël të bëhet edhe e koordinuar. Jo bashkitë që kanë mundësi të marrin të ardhura, ne e kemi mundësinë që ta reflektojmë në legjislacion dhe t'i fuqizojmë dhe bashkitë që në territore janë shumë të mëdha dhe ne i konsiderojmë të vogla. S'janë të vogla, me Malli është e vogël. As në territor dhe as në numër banorësh, se s'mund të konsiderohet e tillë. Prandaj, hajde të gjejmë zgjidhjet, mos i vëmë në pozitën që ju si bëni këto dhe ju rrezikoheni, se u përcoll kjo atmosferë dhe nuk dua që ata të jenë në atë trysinë e heqjes së bashkisë së tyre. Këtë e kisha si ndërhyrje, zoti Haxhinasto, fjala për ju.

Edmond Haxhinasto:

Faleminderit. Unë për procedurë e kam ndërhyrjen. E para, ju lutem, meqë na keni vënë orën përpara, ta respektojmë orën e ndërhyrjes së secilit. E dyta, ju lutem juve bashkëkryetarëve, duke qenë se kemi edhe një mik shumë të nderuar sot që vjen nga linguistika, mos lejoni, mos lejoni terma të tillë që është shtuar vëmendja, terma që janë politikisht korrekt, por nuk s'kanë të bëjnë fare me thelbin e gjësë. Ju lutem, përqendroni termat në vlerësime. Desha të vlerësoj pyetjet e zotit Elezi, ishin shumë të qarta. Përqendrohuni tek korrelacioni midis dy gjërave: madhësia, financimet, etj. Kjo, këto janë alternativa që duhet të diskutojmë. Sepse, duke folur dhe duke i krijuar hapësirën, që unë i përshëndes të gjithë dhe i falënderoj për prezencën e tyre, mendoj që ndërsa bëjmë thirrje për mos të folur politikisht, po dëgjoj më tepër komente politike sesa racionale edhe të bazuara tek fokusi i alternativave që duhet të diskutojmë. Alternativat duket qartë tashmë se ku qëndrojnë. Ju krahuan, ti doni të argumentoni që duhen më të vogla, domethënë më të mëdha bashkitë. Ne themi që nuk është ky kriteri, nuk është territori që përcakton, është shërbimi dhe afërsia ndaj qytetarëve. Ndërkohë që nga zonja e nderuar dëgjuam që thotë që nuk kanë rëndësi madhësitë e bashkive. Që jep konsiderata të cilat i përkasin këtij komisioni. Me gjithë respektin për ju, ky komision këtu është nga parlamenti, përbërë nga parlamentarë. Ju mund të jeni e zgjedhur, mund të jeni e caktuar, por na leni ne të kemi diskrecionin që të konkludojmë edhe të përcaktojmë ne çfarë përjasje do kemi përse i takon asaj detyre që kemi marrë. Më kuptoni çfarë dua të them? Pra, i takon këtij komisioni që në fund fare të konkludojë çfarë kriteresh do marrim konsideratë për të dhënë mendimin tonë dhe për të shkruar raportin. Kështu që këtu na e kurseni, ju lutem shumë, ndërhyrjen. Prandaj, ju lutem bashkëkryetarëve që edhe për arsye të efikasitetit të punës sonë, konceptet që duhet të marrim inpute janë shumë të qarta. Për ne, shumë e rëndësishme patjetër shërbimi që i bëhet qytetarëve. Sa larg është shërbimi ndaj qytetarëve dhe çfarë pasojash kanë sjellë kjo distancë, këto cilësi shërbimesh, këto investime tek zhvillimi ekonomik, tek cilësia e jetës së qytetarëve, tek

largimet ose jo nga zonat ku ato kanë banuar? Ju lutem, të fokusohemi tek këto gjëra. Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Zoti Dule.

Vangjel Dule:

Faleminderit shumë, të nderuar kryetarë të bashkive, të qarkut Gjirokastrë, mirë se erdhët. Unë do të dëshiroja të shtroja 2-3 elemente që besoj se janë të rëndësishme për punën e komisionit tonë, duke kërkuar mendimin tuaj. Së pari, flitet për kompetenca. Kompetencat janë një çështje të cilat nuk kërkojnë domosdoshmërisht një reformë territoriale administrative për t'u riparë. Mund të bëhen amendime të një natyre tjetër të një grupi deputetësh, të grupeve parlamentare, dhe në qoftë se ekziston vullneti politik i seancës plenare, mund të miratohen. Pyetja ime për juve është: nëse këto shqetësime për kompetenca të cinguar ose të munguara a kanë qenë objekt diskutimesh të shoqatës së kryebashkiakëve të vendit dhe a janë kanalizuar ato në qeveri me qëllim që të gjejnë zgjidhjen e tyre? E dyta, qarku i Gjirokastrës, jemi, sepse janë banorë atij qarku, qarku me numrin më të ulët të lindjeve në vitin 2025, në shifra absolute. Këtë shqetësim a e konstatojnë juve në aktivitetin tuaj? A e keni përcjellë? A keni ndonjë ide? A keni ndonjë plan se si duhet trajtuar? Sepse pas disa vitesh do të zihemi midis bashkive të qarkut se ku do të kemi disa klasa, jo më shkolla. Dhe se ku do i kemi këto klasa. Pra, është e kaq dramatike situata demografike në qark. Dhe një element të tretë që nuk e kam aq me juve sesa me kolegët: mos vëmë kritere të cilat janë sensacionale, por që në thelb fshehin të tjera elemente dhe çështje që është përgjegjësia jonë t'i trajtojmë. Ku e kam fjalën? Natyrisht që çfarë mund t'i kërkojë bashkisë, them për shembull, të Libohovës për të rritur të ardhurat lokale? Çfarë mund t'i kërkojë një bashki tjetër të qarkut apo të qarqeve të tjera? Ne duhet të jemi suportues në kahun e kundërt dhe duhet të bëhemi një zë që, ashtu si vend, ne aspirojmë që të përfshihemi së shpejti në programet e kohezionit të Bashkimit Evropian. Politika të tilla duhet të implementojmë në vend, në mbështetje financiare, ku transfertat në përqindje duhet të rriten për bashki të cilat janë më të vogla, më të varfra dhe gjeografikisht më të mëdha, dhe për rrjedhojë hasin vështirësi shumë më të mëdha për ofrimin e shërbimeve. Prandaj, do të dëshiroja, të nderuar kryetarë bashkish, po të ishit shumë të shkurtër dhe "to the point" në ato që do na thonin në lidhje me këto dy çështje. Ju faleminderit.

Luçiano Boçi:

Fjala për ju, zoti/zonja.

Leonard Hide:

Atëherë, të gjitha këto probleme që po dalin janë trajtuar, janë diskutuar në shoqatën e kryetarëve të bashkisë. Është duke u përpunuar drafti nga ana e drejtuesve dhe të gjitha këto problematika do të shkojnë në qeveri. Me dijeninë time, do të shkojnë në qeveri për të gjetur pjesën e zgjidhjes. Është e vërtetë që kemi lindje, lindje, shumë pak lindje. Nuk do të thotë që edhe ata që kanë ngelur, mosha e tretë, nuk kanë të drejtë të jetojnë dhe ata. Është e vërtetë pjesa e të ardhurave, se sa të ardhura kemi dhe sa na kushtëzon

shumë pjesa e emigracionit. Domethënë, shumë njerëz i kemi jashtë dhe momentet të ardhurave t'i mbledhim në momentet që ata bëhen prezent, që vijnë prezent në sezonin e festave. Do të doja, për zotin Axhinas, do të thoja diçka. Ne vërtetë kemi të zgjedhur. Por personalisht nuk dua që të politizoj pjesën e debatit. Kam ardhur këtu për të sjellë atë çfarë mendon komuniteti, qoftë majtas, qoftë djathtas. Por komuniteti aty mendon dhe do që ajo bashki të ekzistojë. Para disa ditësh, doja ta sillja këtë në vëmendjen tuaj, dëshirën e madhe që ka edhe brezi i ri që kemi me ata që kanë ngelur në ato klasa që janë. Ne si bashki kemi mbështetur e suportuar një grup të rinjsh të shkollave nëntëvjeçare të mesme, të cilët kanë organizuar dhe kanë krijuar një ansambël libohova. Te grapi i Libohovës, para disa ditësh, me iniciativën e tyre, isha u befasova, singërisht u befasova dhe po më gjetet mishi kur e mora atë mesazh nga ana e tyre. Aty pashë dhe ata kërkonin me forcë se duan të thonë dhe unë doja ta transmetoja këtu. Fjala e tyre ishte: "Xhaxhi Nardi, të lutem, komisionit t'i thoni, t'i drejtoheni. Në qoftë se doni të kuptoni se pse e duam ne bashkinë të ekzistojë, merrni për një çast sytë tonë dhe zemrën tonë dhe do ta kuptoni se pse ne e kemi të nevojshme që Libohova të ekzistojë." Zoti Navbati nuk është nga e deleguara kjo. Kjo çfarë thashë?

Luçiano Boçi:

Atëherë, tjetër nga kryetarët e tjerë të bashkive, ka një përgjigje? Vetëm Libohova, vetëm për Libohovën e kishte pyetjen zoti Dule.

Vangjel Dule:

A mund të drejtë replikës?

Luçiano Boçi:

Po, jo, mund të bësh një koment?

Vangjel Dule:

E kam, e kam.

Luçiano Boçi:

Dëgjon, ja një koment, zoti Dule.

Vangjel Dule:

Thjesht do dëshiroja të thosha se është në vullnetin e tyre për t'u përgjigjur ose jo, por ky është një shqetësim dhe është e rëndësishme që këtu janë edhe dy deputetët e qarkut, kolegët e nderuar, zoti Shehu edhe zonja Kumbaro. Realisht duhen mbështetur kryesisht ato bashki me të cilat në një pjesë të mirë të tavolinës sonë ekziston ideja se ngaqë janë të varfra me pamundësi financiare, duhet që të bashkohen. Zgjidhja që kemi dhënë me këto bashkime tregon se nuk ka funksionuar. Bashkimi mund të ketë kursyer disa fonde nga qeveria qendrore, por ka ndikuar negativisht në shumë aspekte, përfshirë edhe demografinë, që është themelore. Prandaj do dëshiroja që, prandaj pyeta nëse këto diskutime që po ndodhin këtu janë zhvilluar në shoqatën e kryetarëve të bashkive. Tani, nëse do presim 9 muaj përpara zhvillimit të zgjedhjeve të ardhshme, pasi është ezauruar mandati që t'ia përcjellim qeverisë dhe të presim zgjidhjen në lidhje me rritjen e kompetencave apo me shndërrimin e këtyre kompetencave që ekzistojnë në funksionale, jemi tepër vonë. Duhet ta kishim bërë dhe duhet të ishim gjetur zgjidhje dhe duhet ta

konceptojmë veten juve, se edhe ne si deputetë po se po, që atë autonomi që pretendojmë ta ushtrojmë, të mos funksionojmë si pushtet vendor, si dora e zgjatur e pushtetit qendror. Performanca juaj është zhgënjyese. Përse është zhgënjyese? Se ju pranoni rolin e nxënësit të bindur të kryetarit të një partie, i cili ju thotë: "Shohuni" dhe ju çoheni. U thotë: "Uluni" dhe juve uluni. Ju thotë: "Pushoni se do ju nxjerrë për jashtë." Sapo artikulonit diçka që nuk ju pëlqen dhe juve pranoni heshturat. Kjo nuk është, nuk dëshmon autonomi të pushtetit vendor dhe nuk bindni askënd që jeton në këtë vend dhe e njeh këtë rezultat, se juve të kërkoni më shumë kompetenca. Edhe po t'i keni, unë besoj se juve nuk do t'i ushtroheni. Juve të gjithë, brenda një kohe rekord, ndryshohatë nën kryetarët tuaj sepse kështu i pëlqeu kryetarit të qeverisë, duke mos ditur se si funksionon me ju, duke mos ditur pse e keni zgjedhur juve, duke mos ditur se në çfarë niveli u janë përgjigjur kërkesave të atyre pozicioneve që juve u keni ngarkuar. Prandaj them që të jemi realistë, problemet që ka krijuar 2014 janë shumë të mëdha dhe nuk do t'u japim dot zgjidhje në qoftë se nuk jemi të sinqertë me njëri-tjetrin. Faleminderit.

Luçiano Boçi:

Faleminderit, zoti Dule. Tani, në raport me përgjigjet që duhet të japin kryetarët e bashkive, po, janë Bert, janë një minutë. Në raport me kryetarët e bashkive, nuk jemi në seancë heshtje, jemi në seancë dëgjimore. Po, tani kryetarët e bashkive nuk mund të shmangen duke heshtur. Jepni një përgjigje për të gjitha pyetjet që bëjnë deputetët. Është kusht. Prandaj jemi këtu bashkë për këtë gjë. Faleminderit. Po, Bert.

Albert Malaj:

Në përgjigje të zotit Dule, doja të thosha që shoqata e të zgjedhurve vendorë ka kundërshtuar uzurpimin nga qeveria të kompetencave, duke filluar nga shërbimet publike, në ujësjellësa, në mbetjet urbane, leje ndërtimi, etj. Është hartuar një rezolutë dhe për këtë i jemi drejtuar Kongresit të autoriteteve lokale. Faleminderit.

Luçiano Boçi:

Po. Po, ishte Bled Joni. Jo, jo, ishte një, po, ishte për procedurë se e kërkoi. Jo, ishte, nuk ishte kështu për pyetje.

Klevis Jahaj:

Shumë faleminderit, kryetar. Në fakt, edhe unë doja që të tërhiqja pak vëmendjen që në një farë mënyre mos ta kishim këtë një koment ndërmjet diskutimeve ose përgjigjeve që marrim nga ata, po pyetje për të marrë përgjigje që ne duam për të na shërbyer në funksion të detyrave që kemi si anëtarë të komisionit. Dhe në fakt, së bashku me komentin edhe me atë që u shpreh këtu, që nuk duhet të ndjeni presion për pjesën e ndarjes edhe të gjitha me radhë, nuk besoj që qëllimi i kësaj dëgjese është pikërisht që hajde të diskutojmë se si do t'i ndajmë territoret. Qëllimi i kësaj dëgjese është si të përmirësojmë ose t'ju vijmë në ndihmë në lidhje me funksionet që ju keni. Dhe në fakt, edhe në artikulin ose në diskursin që ju bëtë, thatë që pikërisht, të paktën nga Bashkia Dropull, por edhe nga kolegë të tjerë tuaj, që ka disa funksione të cilët, për shkak të kostove të larta, është e pamundur që të kryhen nga bashkia në kushtet që janë tani ose me të ardhurat në të cilat ato i gjenerojnë. Dhe pyetja ime është: a mund të listoni ju kush janë funksionet që mendoni që mund të kryhen ose të jepen në nivel rajoni? Dhe ndoshta kjo, duke mbuluar dhe duke ndarë kostot me njëri-tjetrin, a ka funksione të cilët ju nuk i keni dhe mund të kryhen? Këtu marr shkak edhe nga komenti i kryetarit të bashkisë Tepelenës që kemi

kërkesa nga qytetarët për shërbimet e energjisë elektrike. Çfarë shërbimesh mund të kryejë bashkia në lidhje me OSHE-në për t'ju përgjigjur qytetarëve? Ju përmendni këtu që ne kemi të ardhura të pamjaftueshme dhe kërkojmë rritjen e fondit të kushtueshëm. Mund të kemi një kalkulim nga ana juaj se sa është rritja e fondit të kushtueshëm që ju kërkon? Sa për kjo rritje e fondit të kushtueshëm shkon për mbulimin e kostove operative? Gjithashtu, a keni ju një llogari se sa janë të ardhurat që vijnë në forma të tjera nëpërmjet investimeve nga qeveria qendrore, nëpërmjet agjencive ose si fondi i shërbimit ose agjencia e ujësjellësa, kanalizimeve, të cilat ndihmojnë bashkinë tuaj dhe mund të futen në kalkulimin pikërisht të këtyre të fondit të kushtueshëm që ju mendoni që duhet të rritet? Gjithashtu, kam edhe një pyetje të fundit dhe mendoj kjo është për diskutim dhe nuk janë pyetjet e fundit të mia. A ka nga reforma e parë territoriale terriore të cilat mund të korrigjohen dhe mund të bëhen pjesë e bashkisë tuaj për shkak të problematikave që mund të ketë pasur nga reforma e parë? Pra, zona, fshatra, krahina ose lagje të caktuara të cilat mbulohet shërbimi nga një bashki tani, po ndërkohë mund të jenë edhe nga ana identitare ose të afërsisë territoriale ose të aksesit që ju keni nga bashkitë që ju mbuloni. Dhe një pyetje të fundit: a keni ju ndonjë analizë ose kërkesë të posaçme në qoftë se duhet të ketë një rritje të rolit të njësive administrative, të administratorëve dhe të stafeve të cilët operojnë në njësitë administrative? Shumë faleminderit.

Dhimitraq Toli:

Bashkia Dropull është, unë them që reforma e 2014-s për Bashkinë Dropull është një nga reformat më të mira, se janë bashkuar 3 ish-komunat minoritare dhe janë bërë një. Siç është bërë dhe Finiqi. Domethënë, nuk për neve ka funksionuar reforma territoriale. Problemi është te fondet e pakushtueshme që vijnë në bashki. Ato duhen të rishikuar, si për shembull rrugët rurale, që është kryesorja për bashkinë tonë. Për ujitje, për vaditje. Këto thamë që duhen rishikuar. Se neve na kaluan mirëmbajtjen e rrugëve, po me një fond për ditë punonjës. Nuk arrijnë në ajo. Se unë kam një zonë që është njësi administrative pagonë, që është shumë e vështirë. Dhe pa ndihmën e qeverisë, nuk mund të bëj unë rrugë. Bashkia Dropull ka fituar 5 projekte të huaja. Edhe me bashkitë e Greqisë dhe me bashkitë e Italisë bashkëpunojmë. Po, edhe kjo është një masë për bashkitë që duhet të, siç tha dhe nënkryetarja Gjirokastrës, që kemi ngritur një drejtor për projektet. Ne kemi një sektor për projektet dhe çdo bashki duhet të merret dhe me projektet. Nuk duhet të shikojmë vetëm fondet e qeverisë. Po, fondet e qeverisë, këto që e kemi thënë, e kemi thënë dhe te mbledhja që kishim të gjithë me të gjithë kryetarët e bashkive. Dhe siç dha dhe kryetari me mallej, këto janë adresuar të gjitha dhe ne presim t'u drejtohen Kuvendit dhe ne presim një përgjigje për problemet që kemi të përditshme që i diskutojmë. Ujësjellësi, ne si bashki nuk mund të kemi fonde të bëjmë ujësjellës. Në Dropull, fondet e ujësjellësive u bënë pas '46-'47-ës. Tani kanë filluar këto vitet e fundit që bëhen prapë ujësjellëse. Po, bashkia nuk ka fuqi të ketë fonde për të bërë ujësjellëse. As rrugë të mëdha. Ne bëjmë rrugë të fshatrave, rrugët që kemi mundësi për të bërë. Këto kemi kërkuar të shikojë qeveria. Edhe Bashkia Dropull, janë bashkuar 3 komuna, është bashki minoritare e thashë dhe në fillim të hapjes së takimit. Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit. Një nga kryetarët tjerë.

Gramoz Sako:

Përshëndetje. Nuk e kisha fjalën për konkretisht për këtë shërbim që sapo folët, po të gjitha problematikat përplasen deri te bashkisë dhe ne s'ju japim dot përgjigje. Nuk ka

lidhje me energjinë elektrike, se aty nuk mungon energjia dhe është. Pastaj për sistemet që foli zoti Toli, që të gjitha këto problematika që ka Bashkia Dropull, i kemi të gjithë. Ne nuk kemi mundësi as për sistemet e ujitjes, as për mirëmbajtjen e rrugëve, po i realizojmë, po. Për çfarë kemi dorë ne, ne nuk na mungon as dëshira, as me çfarë mundësish kemi, ne i realizojmë. Për çfarë detyrash ka bashkia për momentin, detyrat që kemi ne, ne i realizojmë. I shoh gjithë kolegët se i ndjek dhe edhe për punët që bëjnë, që jemi të gjithë të angazhuar për të realizuar gjithçka në ndihmë të qytetarëve. Faleminderit.

Luçiano Boçi:

Bashkia Këlcyrë.

Bashkia Këlcyrë (Albiona Hoxha):

Përshëndetje të nderuar. Është kënaqësi dhe privilegj që mundem të jem sot në këtë tryezë me ju. Unë jam Albiona Hoxha, nënkryetare e Bashkisë Këlcyrë. Nisim nga çfarë është diskutuar deri tani, nga pyetjet që janë ndërtuar edhe nga çfarë përgjigjesh apo fjalimesh kanë dhënë kryetarët edhe nënkryetarja. Bashkohem me ta për faktin se, pavarësisht se jemi bashki të ndryshme dhe kemi sfida edhe problematika të ndryshme, edhe pse jemi pjesë e të njëjtit qark dhe kështu besoj funksionon për të gjithë, prapë qëllimin dhe objektivin e kemi të njëjtë për t'i shërbyer komunitetit, për t'i shërbyer me dinjitet komunitetit. Është e vërtetë që bashkitë e vogla kanë vështirësi të mëdha të kapacitetet njerëzore, domethënë kanë shumë pak burime njerëzore edhe financiare. Por ne kemi parë të arsyeshme të fuqizohen shërbimet me qëllim për t'u shërbyer atyre akoma më mirë. Nisur edhe nga pyetja e fundit që u bë kryesisht në lidhje me kompetencat edhe si duhen ndarë ato midis pushtetit vendor edhe qendror. Mendoj që kur vjen puna për këtë ndarjen e përgjegjësisë midis pushtetit vendor edhe qendror, duhet patur parasysh se ato attribute, ato kompetenca, ato procese që prekin drejtpërsëdrejti jetën e përditshme të qytetarëve, ti qëndrojnë pushtetit vendor. Kurse ato shërbime apo kompetenca që kanë nevojë për politikëbërje, për vizion më afatgjatë, për strategji, le t'i qëndrojnë pushtetit qendror. Ama, një nga gjërat që u prek dhe u diskutua pak a shumë në të gjitha pyetjet ishte shpërndarja e financimit. Bashkitë e vogla e konfirmoj, jo vetëm unë, por dihet që e kanë shumë të vështirë vetëfinancimin. Nuk mund të bëjnë thuajse asgjë me vetëfinancimin, sidomos bashkitë që kanë një numër shumë të vogël biznesesh. Ama, thënë kjo, do të sugjeronim që të shikohej pikërisht formula e shpërndarjes së financimit. Në territorin e Republikës së Shqipërisë ka bashki që kanë një buxhet shumë të madh dhe deri diku ndoshta edhe të mjaftueshëm, ashtu siç ka bashki të vogla, buxheti i së cilës është i pamjaftueshëm për të kryer edhe investime që kanë një interes të lartë publik. Kështu që këto mund të ishin disa nga këndvështrimet që u bashkohen kolegëve, por në të njëjtën kohë edhe që vlen të theksohen. Faleminderit.

Luçiano Boçi:

Po, zoti Jaj, një koment.

Klevis Jahaj:

Domethënë, mendoj që për t'i ardhur në ndihmë këtij komisioni, është shumë e rëndësishme që ne realisht të kemi disa përgjigje të sinqerta që thuhet. Ne për funksionin e ose po them për menaxhimin e integruar të mbetjeve, e kemi shumë të vështirë. Mendojmë që ne po të jetë një zgjidhje rajonale, që mund të jetë dhe do të jetë dhe ka propozim dhe nuk ka të bëjë me ndryshimin e territorit, por ka të bëjë me ndryshimin e

funksionit ose të zhvillimit rajonal, të institucionalizimit ose përfshirjen e tyre në disa nga ligjet, duke qenë se jemi duke u marrë me një komision të reformës dhe nuk ka të bëjë vetëm me territoriale, por dhe ana administrative ose institucionalizimin e disa strukturave të caktuara që tani mund të kenë zgjidhje nga vullneti i pushtetit lokal, por mund të jenë edhe më të institucionalizuar dhe si produkt i kësaj tavoline, tryeze dhe kësaj reformës së posaçme. Dhe realisht pres që të kemi një kontribut real nga të gjithë ju për listën e atyre funksioneve që mendoni janë të pamundura për të kryer në nivelin dhe të ardhurat që ju keni. Të keni një propozim real në lidhje me se si duhet të shpërndahet konkretisht pjesa e fondeve të kushtueshme, se jam shumë i sigurt që këtu nuk thuhet të gjitha, por një pjesë e madhe e të ardhurave që vijnë në mbështetje nga qeveria qendrore vijnë si investime direkte në zonën tuaj. Pra, nuk do të thotë që fondet e pakushtueshme janë direkt vetëm dhe ju duhet t'i menaxhoni për të kryer, por është dhe nga kapaciteti i bashkive dhe vijnë prapë te diskutimi për të menaxhuar projekte të cilat janë të një madhësie të caktuar. Kështu që mendoj që është shumë e rëndësishme që të jemi sa më interaktivë në lidhje me këto komente dhe mendoj që thelbi kryesor i fokusit të diskutimit nuk është bashkimi, ndarja, zvogëlimi apo jo i bashkive, por është pikërisht kush është shqetësimi më i madh, se si t'i shërbejmë qytetarëve dhe çfarë shërbime ne mund të arrijmë me kapacitetet që kemi. Jemi në vitin 2026, nuk po flasim këtu sa ishim, ku ishim në 2014-ën, por në kushtet që jemi dhe në situatën demografike, ekonomike në të cilat janë bashkitë dhe territoret të cilat ju mbulonin. Edhe unë jam deputet, se nuk është justifikim ky që vijnë na flasin të gjithë qytetarët dhe mua ditë për ditë më flasin të gjithë qytetarët. Nuk kam as staf, as ndonjë gjë, por merren dhe interesohen në të gjithë institucionet. Çfarë do të thotë që duhet të kesh funksionet vetë që t'i kryesh këto? Jo. Ke të gjitha instrumentet ligjore për të deleguar në institucione të tjera për të lënë një zgjidhje në lidhje me qytetarët që përfaqëson. Kështu që unë nuk besoj që diskutimi është që kemi këto gjëra dhe nuk i bëjmë. Unë mendoj që ajo që është më e rëndësishme, të tregojmë institucionalisht dhe të themi që me kapacitetet që kemi aktualisht, territorin, largësinë territoriale, ne duhet të ndryshojmë këto lloj kompetencash në njësinë administrative dhe janë disa funksione rajonale të cilat ne nuk i mbulojmë dot me të ardhurat aktuale që kemi. Dhe po, ky është kontributi që jemi. Dhe unë mendoj që ka zgjidhje duke përdorur ekonominë e shkallës, rritjen e kapaciteteve të caktuara, ngritjen e zyrave rajonale të projekteve që mund të jenë në nivele të reja të njësive administrative territoriale. Dhe kjo nuk do të thotë që domosdoshmërisht do ketë shkrirje të bashkive apo diçka tjetër, por mund të ketë nivele të caktuara kompetencash për territoret tuaja dhe të administrimit. Dhe në qoftë se ju keni një mendim për këtë, po, do të ishte në interes të komisionit. Shumë faleminderit.

Bashkia Gjirokastrë (Artiste Koko)

A mundem?

Luçiano Boçi:

Po.

Bashkia Gjirokastrë (Artiste Koko)

Në vijimësitë të asaj çka u tha. Po, ekzistojnë analizat në bashki. Cilat janë funksionet të cilat kërkojnë në bashkia nuk arrin dot t'i mbulojë me fonde? Ujitja dhe kullimi. Rrugët rurale, të cilat janë bashkuar bashkisë për numrin e personelit, 10 persona që në 2015-ën dhe nuk është bërë vlerësimi i këtyre transfertave për funksionet e deleguara që nga 2015-a. Arsimi parashkollor, arsimi parauniversitar, turizmi, trashëgimia, uji, ujësjellësat.

Ujësjiellësat nuk mund t'i mbajë bashkia, nuk ka as fuqi financiare dhe as kapacitete të burimeve njerëzore. Ujitja dhe kullimi, bëjnë thjesht, bashkitë bëjnë thjesht mirëmbajtjen. Fondi që vjen i deleguar nga pushteti qendror, që vjen i deleguar nga pushteti qendror, mbulon vetëm pagat e 10 punonjësve për ujitjen. Po kështu dhe për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave. Fondi që vjen nga pushteti qendror, mbulon fondet e pagave vetëm për 10 punonjës, siç janë transferuar nga 2015-a, janë rritur sepse kuadri ligjor përcakton që transfertat e vitit 2026 nuk mund të jetë më e vogël se 2025-a, por realisht nuk ka vlerësime për atë çfarë ndodh në terren dhe sa janë kostot e bashkive. Por pushteti qendror i ndihmon bashkitë nëpërmjet transfertave të kushtzuar. Ne vërtet nuk kemi transfertë të pakushtueshme për funksionet e deleguara, por kemi marrë investime strategjike për zhvillimin e bujqësisë, për zhvillimin e ujitjes dhe kullimit, për planet e menaxhimit. Mund të kemi fonde për ngritjen e planeve të menaxhimit për pyje e kullota, por nuk kemi administratë. Në këto kushte do të sugjerohet që planet strategjike të zhvilloheshin në pushtetin qendror dhe bashkia të ishte ajo për zbatimin e tyre. Sepse viti i tretë si vjet që prokurojmë, të vijmë dhe tek çështja e prokurimit të shërbimit nga jashtë, prokurojmë për ngritjen e planeve të menaxhimit të pyjeve e kullotave dhe për të tretin vit dështojnë procedurat. Që do të thotë ka mangësi kuadri ligjor, ka mangësi kompetencash, ndarjet e kompetencave dhe si rezultat nuk arrijmë dot që të kemi një dokument në dorë. Do të thotë që bashkitë kanë ende nevojë për mbështetjen e planeve strategjike dhe pastaj ato të ata shohin tek bashkia. Ekzistojnë analiza dhe ka evidenca të sakta në vlera absolute se sa pushteti qendror i mbështet bashkitë, sepse me fondet e veta bashkitë nuk mundet të bëjnë mirëmbajtjen e rrugëve rurale. 475 m2 bashkia Gjirokastër dhe mund ta mbajë vetëm transfertat e pakushtueshme sektoriale në 8 milion lekë. Është e paarritshme, por edhe 1 miliard që është buxheti i bashkisë Gjirokastër, as ajo nuk arrin dot ta mbulojë me shërbim të mirëmbajtjes apo rehabilitimit të rrugëve rurale. Janë investime strategjike të pushtetit qendror që mbështesin bashkitë. Po kështu edhe tek arsimit, po kështu edhe tek planet, edhe tek menaxhimi i pyjeve e kullotave në mbështetjen. Ujësjiellësat është e pamundur për t'i mbajtur. Vetëm në 2020-ën bashkia Gjirokastër ka marrë 267 milion lekë për investimin në ujësjiellës të një njësie administrative. Duhet të rritet, nëse do të shikohet si mundësi të rritet kompetenca e njëjësive administrative që tashmë ekzistojnë ish-komunat e njëjësive administrative. Mund të jetë rritja e kompetencës, pavarësisht se shërbimi nuk i pengon, por nuk i pengon në kompetencën e tyre. E vetmja gjë që mund të rishikohet aty në sugjerimin tim do të ishte forma e zgjedhjes së administratorit, që administratori të arrijë të zgjidhet nga vetë komuniteti, ashtu siç bëhet dhe përfaqësia e rurale. Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit. Zoti Nallbati, kështu një pyetje.

Bledion Nallbati:

Faleminderit. Tani, duke marrë për referencë edhe fjalën e zotit Klosi, anëtarit të komisionit që na përgëzoi e na bëri komente pozitive, por na bëri qartë edhe se sa kishim kuptuar akoma në që reforma paska qenë e suksesshme, kjo reforma e 2014-ës. Nga sa dëgjova kryetarët e bashkive edhe nënkryetarët, rezultoi që ka një sërë problematikash të rëndësishme që kjo reformë paska dhe paska bërë të pamundur ofrimin e shërbimeve të për një numër të caktuar, të një numër të caktuar shërbimesh të rëndësishme që bashkitë e paskan të pamundur ta ofrojnë. Pra, zoti Klosi do të thotë që krisma paska pasur të ai. Reforma nuk qenë nga ajo që pretendoni ju. Tani, të nderuar kryetarë dhe nënkryetarë, meqë mu referove zoti Hide, duhet të dish që toga e pushkatimit të bashkive nuk është në këtë krah, është në atë krah. E ke ngatërruar, e ke ngatërruar, e ke ngatërruar drejtimin. Tani, a ka mundësi oti Zotëri Dajan, kur ta marrësh fjalën, pastaj thuaj çfarë duash. Kur ta

marrësh fjalën, a ka mundësi tani mos më ndryshmë? Doktor, më qetë o doktor, më qetë o doktor, o doktor, po më qetë. Shiko, a mund ta vazhdojmë edhe të mos i ndërhyjmë njëri-tjetrit se pastaj. Po, ka një respekt për atë që dëgjon dhe për ata që na dëgjojnë. E mund të futi një aspirinë edhe qetësohesh. Po tani, shiko, nga pala këtë e më thanë që të keni të qartë e komisionit pretendohet që bashkitë nuk performojnë ekonomikisht dhe për rrjedhojë do të duhet të bashkohen, të shkrihen dhe të bashkohen në njësitë më të mëdha me idenë që do të kenë mundësinë për të performuar më mirë. Hidhet edhe ideja e krijimit të një rajoneve ku një pjesë të madhe të kompetencave të bashkive, të kryetarëve të bashkive do t'i marrë rajoni me pretendimin që do të ofrojnë shërbime më të mira dhe më cilësore dhe në kohë më të afërt ndaj qytetarit. Pyetja që unë kam për ju është konkrete: a mendoni ju që shkrija e bashkive tuaja në njësitë më të mëdha e përmirëson cilësinë e shërbimeve të atyre që ju pretendoni që i ofroni mirë, por edhe të atyre për të cilat ju shprehet rezerva për pamundësi? Dhe kjo pamundësi, unë kam qenë vetë kryetar bashkie në kohën kur u bë kjo reformë dhe e di mirë se çfarë problematikash ka, sidomos atëherë që ishte çdo ditë vinte nga një urdhër ministri, edhe pse kishte një ligj 139/2015-ën, ishte i pazbatueshëm, funksiononte me urdhra ministrash çdo ditë. Çdo ministër zgjohej, nxirrte një urdhër dhe dilte përtej ligjit dhe kemi hequr zile ullirit në atë periudhë për t'i menaxhuar ato bashki. Por sot prapë që të them që në momentin që jemi, ju keni një sërë problematikash dhe problematikat, për mendimin tim, nuk janë nga paaftësia juaj apo e stafeve tuaj për t'i ushtruar këto shërbime. Janë nga mungesa e vullnetit të qeverisë për t'ju suportuar me kompetenca dhe me financa mbi të gjitha. Sepse pretendohej që në qoftë se krijohet rajoni, rajoni do ta bëjë më mirë, do ta ofrojë më mirë shërbimin. Pyetja që kam unë është: ku do t'i marrë paratë rajoni? Do marrë paratë e bashkive? Do ketë taksa apo tarifa shtesë mbi qytetarët për të marrë buxhetin e vet apo do t'i marrë nga buxheti i shtetit? Nëse i merr nga buxheti i shtetit, për kë është kjo pyetje, më fal? Për kryetarët e bashkive? A është pyetje retorike? Por edhe për kolegët më tha. Nëse i merr, është pyetje retorike një ditë. Nëse i merr tani, nëse i merr rajoni paratë nga të ardhurat që marrin sot bashkitë? Nëse i merr nga buxheti i shtetit, atëherë këto para që buxheti i shtetit do t'i japë rajonit, po t'ua jap ju, po t'ua jap ju këto para, a i realizoni ju këto shërbime? Pra, nëse për kompetencat që ju keni sot ju shtohen kompetencat, ju shtohen paratë mbi këto funksione, a i realizoni këto shërbime? Po marr një shembull, për shembull menaxhimin e rrugëve rurale. Nëse një pjesë e fondit.

Që ka sot RSH-ja, që kur bën tenderat e mirëmbajtjes së rrugëve, edhe pse i ka rrugët nacionale, vlera për njësi apo për kilometër që prokuron RSH-ja dhe që vë në dispozicion RSH-ja në raport me ato që keni ju për kilometër për rrugët rurale, është me një diferencë shumë të madhe. Nëse ju do të ishit në të njëjtën vlerë, a do të kishit fond për të mirëmbajtur rrugët me të njëjtën vlerë, a do ta kishit të mundur që t'i mirëmbanit rrugët si duhet? Pretendohet këtu që ju nuk keni kapacitete për të bërë projekte. Është e vërtetë që bashkitë e vogla nuk kanë kapacitete për të bërë projekte, por ky është një mashtrim i madh që ju përdorni për të arritur në atë konkluzionin që doni. Më thoni një projekt që qeveria apo një ministri e bën me inxhinierët e vet, duke nisur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Çdo projekt që bën dhe zbaton në Republikën e Shqipërisë, a ka mundësi tashmë të mos më ndryshoni?

Arbjan Mazniku:

Për projektet e tani kemi?

Bledion Nallbati:

Jo, më fare, mos më ndryshoni.

Arbjan Mazniku:

Ore se u bë 10 minuta tani.

Bledion Nallbati:

Po, 20 vëlla, këtë punë kam unë.

Arbjan Mazniku:

Po jo, ti nuk e punë të bësh fjalimin.

Bledion Nallbati:

Po 20 vëlla.

Arbjan Mazniku:

Kemi në një ditë që bëjmë pyetje ndaj kryetarëve.

Bledion Nallbati:

A ka mundësi tani?

Arbjan Mazniku:

Jo, e them sërish këtë gjënë se e bëmë dhe herës tjetër.

Bledion Nallbati:

Po ta bëj prapë.

Arbjan Mazniku:

Kemi thirrur kryetarët për dëgjes, jo për t'ju dëgjuar juve. Ju do të keni të gjithë kohën e nevojshme të flisni sa dëshironi ju, në komision, parlament, të gjitha, në një ditë ku kemi thirrur kryetarët e bashkive. Është jo etike të merrni kohën e kryetarëve.

Bledion Nallbati:

Ti vazhdo, po unë do të them atë që dua unë të them dhe nuk.

Arbjan Mazniku:

Ore ti do të thuash patjetër që do të them, por ama për sa kohë që kemi një rregull.

Bledion Nallbati:

Dhe nuk më imponohesh dot fare absolutisht.

Arbjan Mazniku:

Jo, jo, rregulli është deputetët i bëjnë pyetje kryetarëve që i kemi thirrur në dëgjesë dhe i kanë lënë detyrat për të ardhur këtu. Të lutem, harto, bëj gjithë pyetjet që dëshiron, 10, 11, 12, por referat për si mund të ishin ndoshta hipotetiki rajonet për të cilat s'kanë detyrë të flasin.

Bledion Nallbati:

Faleminderit shumë.

Arbjan Mazniku:

Nuk mund të jetë kjo gjë. Të lutem, pyetjet që të kemi një formë efektive se s'ka sens. Jeni duke marrë kohën e kryetarëve të bashkive.

Bledion Nallbati:

Unë do të them atë që dua unë të them dhe nuk marr referenca nga ju. Dakord? Askënd tjetër që mërzhitet.

Arbjan Mazniku:

Jo, jo, do merrni patjetër referenca, sepse ka rregulla si funksionon parlamenti.

Arbjan Mazniku:

Fare, fare.

Fare, fare.

Luçiano Boçi:

Tani, ja, të bëj dhe unë një ndërhyrje, zoti Mazniku.

Arbjan Mazniku:

Mundet shumë thjesht ta mbyllim mbledhjen.

Luçiano Boçi:

Ja, një ndërhyrje. Tani është seancë dëgjimore, po është midis nesh dhe kryetarëve të bashkive, po mos harrojmë që është seancë dëgjimore midis nesh të gjithëve këtu dhe publikut. Dhe normal, deputeti është anëtar i komisionit, e zgjedh ai mënyrën si e parashtron pyetjen dhe si e bën pyetjen. S'mund të hyjmë ne në metodikën, në formën e ligjërimit, si e zgjedh. Tani ashtu e ka, e ka me parashtrim, e ka me argumente.

Arbjan Mazniku:

Zotëri, nuk është kështu. Në Parlamentin e Shqipërisë, Parlamenti i Shqipërisë për.

Luçiano Boçi:

Ja, ta çojmë në parlamentin e Shqipërisë.

Arbjan Mazniku:

Parlamenti i Shqipërisë për të gjitha elementët, Parlamenti i Shqipërisë për të gjitha parlamentet e deputetëve.

Luçiano Boçi:

Kjo është ndërhyrja e deputetit.

Arbjan Mazniku:

Jo, jo, nuk është ndërhyrje në parlament. Ne kemi në Parlamentin e Republikës së Shqipërisë për kohën e pyetjeve, për kohën e fjalës së deputetit, për kohën e fjalës së ministrit, për kohën e fjalës, në të gjitha gjërat, në të gjitha gjërat, koha.

Luçiano Boçi:

Në kohë, komisioni s'është i përcaktuar në kohë.

Arbjan Mazniku:

Dhe kemi një kohë të caktuar për të marrë. Sot që po flasim, kemi parashikuar për këtë seancë dëgjimore dy orë, po ju them tani paraprakisht që deri tani janë më shumë se 47 minuta të numëruara, të marra nga fjalime të deputetëve të opozitës. Kjo gjë nga dy orë që kemi lënë për këtë kohë, kjo kohë është marrje me të padrejtë e mundësisë së kryetarëve të bashkive për të folur dhe po uzurpojmë politikisht kohën.

Bledion Nallbati:

Zotëri, dëgjoni një sekondë.

Arbjan Mazniku:

Jo, jo, dëgjoni një sekondë.

Luçiano Boçi:

Jemi këtu për të dëgjuar kryetarët.

Arbjan Mazniku:

Bëjini pyetjet që keni për të bërë. 10, 20, 30, 40, 50.

Luçiano Boçi:

Kryetarët s'po përgjigjen.

Arbjan Mazniku:

Bëjeni pyetjen sërish.

Luçiano Boçi:

Të paktën të flasim një herë të sërish.

Arbjan Mazniku:

Po është e sigurt që unë, personalisht si bashkëkryetar dhe besoj të gjithë kolegët këtu, nuk kemi ardhur të dëgjojmë zotin Nallbati sot.

Luçiano Boçi:

Po unë kam fjalën time, s'po ma le zotit Maznikut t'i thotë marrë fjalën. Prit të flas dhe unë. Do ta jap, po prit të flas dhe unë.

Bledion Nallbati:

Jo, s'ka mbaruar, s'kam filluar akoma.

Luçiano Boçi:

Po pra, edhe njëherë, o Bledion, një minutë. Pra, nuk mund t'ia heqim drejtën deputetit. U bë ky debat. Po ja, një minutë, të mbaroj unë, të vazhdojë zoti Albati, pastaj do e marrë fjalën një nga ju që prevalon ti në këtë rast, me lejen e kolegëve tuaj se ke folur njëherë. Po të la doktori, sepse edhe ju keni radhën tuaj. Po më, zoti Shehu. Pra, edhe po pra, këtë po kërkoj edhe unë, që po këtë po kërkojmë deputetit të flasi sipas mënyrës që e gjykon ai dhe e bën pyetjen sipas parashtrimit të tij. Tashi, t'i vendosim ne këmishë force deputetit që kaq duhet të flasë? Jo, jo, po s'mundet, ne jemi në komision parlamentar.

Bledion Nallbati:

Nuk më nxeh ajo gjë që nuk më nxeh. Është e vogël, nuk më nxeh. Ajo lloj këmishë nuk më nxeh mua.

Arbjan Mazniku:

Sovran është zoti. Por në ka gjëra të tjera, duhet të ketë respekt ndaj konceptit të dëgjesës. Dhe nuk është, nuk zgjidhen. Kemi lënë dy orë për këtë punë dhe kemi sot një orë të tërë që dëgjojmë njerëz që.

Bledion Nallbati:

Po paguajmë ne, s'kemi punë tjetër. Këtë punë paguajmë.

Arbjan Mazniku:

Jo, patjetër, kryetarët e bashkive kanë punë tjetër.

Kryetarët e bashkisë kanë punë tjetër. Edhe ne kemi punë tjetër që bëjmë.

Bledion Nallbati:

E kanë marrë parasysh kur kanë erdhur këtu. Dakord? Tani.

Arbjan Mazniku:

Fokusohuni tek pyetjet në mënyrë që të kemi mundësi të flasim. Kaq.

Bledion Nallbati:

Ti vazhdo, se unë vazhdoj prapë. E filloj nga fillimi, unë s'ka gjë. Ti ndërhyj, unë e filloj prapë nga fillimi. Sa herë të ndërhysh, do ta filloj nga fillimi. Se më ke ndërhyrë 10 herë. Zotëria foli 3 herë. Klevisi dhe askush nga ne. 3 herë e mori fjalën për diskutime, për komente dhe askush nga ne nuk ndërhyri. Ti më ke ndërhyrë 3 herë, 3 herë, 3 herë. Dhe ti ke ndërhyrë 4 herë deri tani. Dhe unë do ta filloj nga fillimi prapë. Ti ndërhyj prapë.

Arbjan Mazniku:

Filloje, vetëm mbaroje. Kjo është e rëndësishme.

Bledion Nallbati:

Po kur të mbarosh ti njëherë, s'ke mbaruar. Pra, dua të përsëris edhe njëherë pyetjet, meqenëse zotërinjtë i bezdisnin edhe të vërtetat për t'u thënë. Se unë e kuptoj që ju bezdisni ju të vërtetat, se ju keni marrë një urdhër, se Edi Ramën e bezdisin 61 kryetarë bashkish, është lodhur, do të ketë 26, dhe ju ka nxjerrë ju këtu që vini me ca argumente të paqena, e nisni t'i trajtoni bashkitë fillimisht si SHPK. Fjala e parë që përmendni është borxhe, borxhe, borxhe, borxhe. Ua kam thënë që ditën 1, po që për borxhe kjo qeveri është e zhytur në borxhe dhe duhet të ishte e shkruar. Meqenëse bashkitë që kanë borxhe do të duhet të shkruhen, atëherë shkruani këtë qeveri se është e zhytur në borxhe. Edhe jepjani menaxhimin Suedisë, Norvegjisë, Shqipërisë. Dakord? Pastaj vini me idenë që nuk kanë kapacitete të bëjnë projekte rajonale apo ndërkufitare, ndërkohë që kjo qeveri, projektet, çdo projekt që zbaton në këtë vend e bën me prokurim, me studio projektimi. Të njëjtën gjë mund të bëjnë edhe bashkitë, nëse edhe ashtu e bëjnë, nëse ju ju jepni fondet e duhura. Dhe vi na tregoni përralla këtu, doni, nuk keni nerva as të dëgjoni, s'doni të dëgjoni të vërtetat. E pra, të nderuar, ua përsëris prapë atë që thashë. Besoj e keni të qartë që kemi ne kundërshtarët tuaj. I keni andej. Jo tuajt, por të qytetarëve që ju përfaqësoni, se nuk është çështja për ju këtu.

Arbjan Mazniku:

Zotëri Nallbati, cila është pyetja? Vazhdoni, vazhdoni.

Bledion Nallbati:

Vazhdo, unë e filloj prapë.

Luçiano Boçi:

Po mirë, tani ashtu e ka.

Bledion Nallbati:

Po pra, ti vazhdo, unë do ta filloj prapë.

Luçiano Boçi:

Dëshiroj ta theksoj diçka dhe do bëj pyetje mbi bazën e asaj. Tani.

Bledion Nallbati:

Të nderuar kryetar, mendoni që shkrirja e bashkive tuaja dhe bashkimi në njësi më të mëdha i shërben më mirë qytetarëve, i realizon më mirë shërbimet që ka për detyrë bashkia, apo e largon shërbimin dhe cilësinë e shërbimit nga qytetari? Ju mendoni që kjo reformë që ne po përpiqemi të bëjmë këtu do të duhet që të rrisë kompetencat dhe financat tuaja, apo do të duhet që të rishikojë numrin e bashkive duke e zvogëluar atë numër dhe duke përbërë njësi më të mëdha? Dhe po e mbyll me këto për momentin, meqenëse u mërzit zoti Mazniku dhe vazhdojmë prapë.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit për pyetjet. T'i japim kohën kryetarëve të përgjigjen? Po.

Albert Malaj:

Po, e dëgjojmë shpesh që thonë bashkitë nuk kanë kapacitete e burime njerëzore për të bërë projekte etj. Unë do të thoja të paktën për bashkinë me Mali, nuk është e vërtetë. Ne kemi kapacitetet për të bërë projekte, por dhe ato që s'i kemi pasur mundësi t'i bëjmë vetë, i kemi prokuruar, janë bërë projektet. Problemi është se këto projekte po flenë nëpër institucionet kush është aplikuar për këto investime. Nuk janë problem burimet njerëzore, është problemi që janë ndarë ca të nënës e ca të njerëzës kur vjen puna për t'u ndarë investimet. Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Po, zoti Hide.

Leonard Hide:

E theksova që në fillim dhe po e theksoj prapë. Këtu nuk luhet, nuk e konsideroj se luhet fati im personal apo fati i bashkisë. Ajo çfarë ne kërkojmë dhe unë çfarë kërkoj, kam ardhur që të sjell zërin e qytetarëve për të thënë në bindjen time se kjo bashki duhet të ekzistojë, sepse në qoftë se largohet, mendoj se do largohen dhe shërbimet nga njerëzit. Këtë e mendoj dhe them duke parë dhe shtrirjen e madhe që ka ajo bashki, flas për zonën e Zagories. Dëshira e njerëzve për t'u kthyer në banesat e tyre ka nevojë për më shumë investime. Ajo çfarë ka filluar, ka 2 vjet që ka filluar një investim me mbështetjen e qeverisë për restaurimin e unazës së Zagories. Ka sjellë një lloj ndryshimi, qoftë edhe në ofrimin e shërbimeve nga ana jonë. Dhe prandaj e theksoj se investimet në këto bashki do ta afrojnë më shumë shërbimin e administratës ndaj komunitetit. Nuk mendoj dhe e theksoj prapë, po sjell përsëri zërin e qytetarëve të asaj bashkie që ajo bashki duhet të ekzistojë.

Bashkia Këlcyrë (Albiona Hoxha):

Nëse mundem.

Po, atëherë e dëgjova me vëmendje fjalën e zotit deputet, preku goxha këndvështrime. Ndoshta një pjesë e tyre arritën të përgjigjeshin tani nga kryetari sapo foli. Megjithatë, vura re që fjalën e nisët me një përshtypje që kishit krijuar nga ato çfarë kemi thënë deri tani, se pra patët përshtypjen se ne nuk jemi të kënaqur apo nuk jemi, nuk jemi pro i idesë se reforma e vitit 2015 ka qenë e suksesshme. Më lejoni ta nis, të paktën këtë pjesë të fjalës, duke thënë se asnjë reformë nuk është perfekte, por e rëndësishme është që reforma të mundet të adresojë problematikat, vështirësitë edhe sfidat e përditshme, ato më jetike, edhe me ato më kryesoret, më të rëndësishmet. I qëndroj bindjes se reforma e vitit 2015 ishte e nevojshme për të adresuar ato sfida edhe vështirësi dhe problematika që kishte pushteti vendor në atë kohë. Nuk besoj se mund ta mohojmë që falë atij vendimi, falë asaj reforme, njësitë e vetëqeverisjes vendore patën mundësi të performonin më mirë, patën mundësi të realizonin investime me interes të lartë publik që deri më përpara kishin qenë të paimagjinueshme që mund të realizoheshin, patën mundësi të realizonin projekte me bashkëpunime brenda dhe jashtë vendit, patën mundësi tjetër shumë e rëndësishme të tërhiqnin burime njerëzore të specializuara që ishin të aftë t'i adresonin dhe deri diku t'i zgjidhnin problematikat që kishte komuniteti çdo ditë. Është e vërtetë, thashë që reformat nuk janë perfekte, por kanë kaluar 11-12 vite që nga ajo reformë. Patjetër që ka nevojë për përmirësim, patjetër që ka nevojë për adaptim, është më se logjike. Por ajo çka ne përpiqemi dhe kemi analizuar edhe themi është se në momentin që ju do të përgatisni reformën e re, të mbani ndoshta në parim apo në konsideratë se reforma e vitit 2015 e pati suksesin e saj dhe kjo reformë e re që do të bëhet le të jetë një përmirësim i saj, pra të mos kemi ndryshim radikal të reformës që po lëmë pas, por reforma e re le të jetë një

përmirësim i atyre gjërave që ndoshta nuk ecin më se logjikisht pas 12 vitesh me atë vizion dhe strategji që po ecim, ndoshta nuk funksionojnë më. Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Dikush nga kryetarët e tjerë ka një përgjigje për pyetjet, zoti Nallbati? Ja, të mbarojmë pyetjet dhe pastaj e keni ju, faleminderit.

Gramoz Sako:

Përgjithësisht, përshëndetje deputet. Përgjithësisht, pyetjet e zotit deputet, i nderuar, patjetër se është miku im, ishin politike. Edhe po ndjekim porosinë që na dha zoti Haxhinasto që mos u merrni me politikëbërjen, po merruni me punët tuaja. Kështu që s'kemi ca.

Arbjan Mazniku:

Po, zotit Toli.

Dhimitraq Toli:

Kolegu kolegu e tha që të mos vazhdojmë të njëjtat të njëjtat që thanë parafolësit, po duhet të diskutojmë dhe diçka për bashkitë, për decentralizimin e funksioneve. Edhe një funksion që kemi, unë e propozoj ose duhet propozuar, besoj unë, është kadastra që është që është një mundësi që bashkitë të funksionojnë si sportele shërbimi për qytetarët. Çështjet e pronësisë përbëjnë një prej çështjeve që hasen më shpesh nga bashkitë dhe ato njohin terrenin dhe problematikat lokale në mënyrë më të detajuar. Ky funksion është vendosur momentalisht në zbatim kohët e fundit për rastet e legalizimit dhe të gjithë kryetarët e bashkive e shikojmë që deri tani ka rezultuar i suksesshëm. Unë këtë kisha, zotit deputet, unë jam bashkia minoritare që jam i kënaqur nga reforma administrativo-territoriale e 2014-s edhe besoj që bashkia Dropull do merret në konsideratë, ngelet bashkim siç është. Po si të doni ju.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit, zoti Toli. Po, zonja Hoxha.

Bashkia Gjirokastrë (Artiste Koko)

Në mendimin tim, pa këtë 10-vjeçar të reformës territoriale të 2014-s, nuk do ishim sot këtu. Reforma territoriale duhet të shikohet në kuadrin e përmirësimit të funksioneve dhe të shërbimit që bashkitë ofrojnë. Nëse nuk do të kishin kaluar këto 10-vjeçar, askush nga ne nuk do ishte në gjendje që të fliste për funksione nëse kanë. Nëse unë di që parashkrimi i çdo procedure në kodin e procedurave administrative 10 vjet është. Kështu që në këtë kuadër kemi nevojë për të përmirësuar. U përmirësuam se nuk dinim se çfarë ishin donatorët e huaj dhe çfarë ishin ekspertët e huaj, ja që i mësuam këto 10-vjeçar. Kemi nevojë të përmirësohemi, por jo të kthehemi pas. Kështu që në këtë prizëm do të dëshiroja që të mbanit në konsideratë përmirësimin e funksioneve që ofrojnë bashkitë, fuqizimin e bashkive. Gjithë pjesa tjetër pastaj ngelet në dorën tuaj.

Bledion Nallbati:

Ja, kam vetëm një.

Jo, procedurat e drejtësisë edhe unë do i kem, jo vetëm ti, po hajde mbaroj.

Blendi Klosi:

Mirë më se tani e kemi me radhë.

Bledion Nallbati:

Apo kam një tani mbas pyetjeve të mia, kam unë të drejtë në koment apo jo?

Jo, jo, jo më se.

Po si, po po, patjetër.

Blendi Klosi:

Ti bëre komentin para.

Po, pa diskutim. Jo, jo, jo, jo më tani, nuk ka asnjë diskutim që ka ecur.

Bledion Nallbati:

Nesër në mëngjes do zihesh për punën e procedurës.

Oh, zihemi që ç'ke me thënë, se kam fare problem atë pjesë, po.

Një minutë për procedurë, një minutë për procedurë.

Okej, po pastaj, një minutë.

Po, po.

Blendi Klosi:

Meqenëse mu drejtuat mua dhe në fakt kisha përgatitur përgjigjen tuaj, që përgjigjen time që të ishte pak më e gjatë, por e tërheq të gjithë përgjigjen time dhe ja lëj përgjigjen atyre çfarë thanë përfaqësuesit e bashkive, sidomos të dy nënkryetarët e bashkisë, qoftë ajo e Këlçyrës, qoftë ajo e Gjirokastrës, të cilët e thanë qartë përgjigjen e pyetjes suaj që në fakt është dhe thelbi i gjithë këtij komisioni edhe debati politik që ne kemi. Reforma e 2014-s është një reformë nga më të suksesshmet që kemi realizuar në Shqipëri, e cila padyshim mbas 10 vjetësh kërkon jo të analizojë situatën e 2014-s, se as nuk diskutohet që realizimi i asaj reforme dhe realizimi i këtyre njësive të pushtetit vendor ka sjellë shumë më tepër shërbime për komunitetin në të gjithë Shqipërinë. Por ama mbas 10 vjetësh kemi nevojë që të përmirësojmë disa gjëra që kanë të bëjnë me funksionet dhe përgjigjja është shumë e thjeshtë. Meqenëse jeni përfaqësues të. Edhe me eksperiencë në parlamentin shqiptar. A i shërbehet më mirë banorëve të Lazaratit sot apo kur Lazarati ka qenë komunë vetë? A i shërbehet sot më mirë Lunxhurisë sesa kur Lunxhuria ka qenë vetë? A i shërbehet sot më mirë Çepos sesa Çepo ka qenë vetë? A i shërbehet më mirë Kardiçit sesa kur Kardiçi ka qenë vetë? Banorët e këtyre njësive sot janë banorë të Gjirokastrës, marrin shërbim si në mes të qytetit dhe në zonën më të largët. Janë banorë të cilët kanë sot shumë më tepër të drejta dhe të drejtat e tyre mbrohen nga njësitë më të forta. Pra, mos e hyjmë në këtë debat, sepse përgjigjja dhe këtu po e mbyll është vota. Dje në një nga sesionet u kërkua referendum. Nuk ka referendum më të mirë sesa vota. Durrësi fiton në garën e fundit

elektorale 15 mijë vota diferencë. Kandidati përfaqësues i reformës së 2014-s përballë kandidatit të humbës.

Trojë Partia, më e kuptuam, por sikur the që u dha mbyllje.

Që ta e kundërshtojnë reformën. Pra, njerëzit votojnë dhe njerëzit e kanë votuar në mazhorancë reformën e 2014-s.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit shumë. Komentet, zoti Nallbati.

Bledion Nallbati:

Okej. Tani, nisur nga kjo që sapo dëgjova për sukseset e reformës, unë nuk kam asnjë dyshim dhe nuk prisja që ju të thoni gjë tjetër, se ju thoni për shembull që edhe reforma e gjyqësorit, arta e re gjyqësore që bëhet, është një sukses i paparë. Po sot nuk ke shans të bësh një divorc pa 4 vjet, se çështjet e tjera shkojnë nga 5 në 25 vjet. Për ju është sukses. E mbylle, e mbylle me mik edhe ti, se s'e mbyllje dot. Pra, ne mund të bëjmë shaka sa duam, po sot për shkak të asaj reforme gjyqësore që u bëhet, çështjet gjyqësore dhe e drejta në Shqipëri është bërë e pamundur. Dhe të njëjtën gjë thoni dhe për këtë ju. Tani, kryetarët e bashkive, pak me lezet, disa ishin të drejtpërdrejtë, disa më mjeshtër, pak me lezet, iu shmangën pyetjeve. Unë kisha dy pyetje që e doja përgjigjen shumë të shkurtër e shumë të drejtpërdrejtë. Bashkitë që keni duhet të qëndrojnë apo të shkrihen, e para? Dhe e dyta, nëse për kompetencat që keni financoheni më mirë se kjo teoria, paratë e bashkive, paratë e shtetit, në fund të tëra këto janë paratë e qytetarëve. Si shkojnë në buxhetin e shtetit? Si shkojnë në buxhetin e bashkisë? Këto janë taksa që paguajnë po këta qytetarë të Republikës së Shqipërisë. Sa të shkojnë në buxhetin e shtetit dhe t'i marrë për shembull, ku di unë, Belinda apo Akshi dhe t'i bëjë rushe kumbulla, të shkojnë në buxhetin e bashkive dhe nëse këto para vijnë në buxhetin tuaj, a i realizoni do t'ju këto shërbime për të cilat sot keni probleme apo jo? Kaq ishte pyetja. E thjeshtë fare. Pastaj për sukseset e reformës, sukseset e qeverisë, i dimë ne, nuk ka nevojë t'i thoni ju. Sukseset e udhëheqjes, i di gjithë shqiptarët. Sa mirë ju shërbehet sot atyre qytetarëve që janë në zonat e larta e të thella, e dimë ne? E dinë edhe ata të shkretë po të kesh mundësi t'i thërresh ashtu. Ja, u sqarojnë ata, ja u thonë sa mirë ju shërbehet. Se thashë, kam qenë kryetar bashkie vetëm. Sa më larg dhe sa më i madh të jetë territori, sa më larg të jetë kryetari i bashkisë, aq më shumë shuhen shërbimet. Shuhen, fiken, nuk ekzistojnë. Kjo të përralla që sa më të mëdhaja, po sa më të mëdhaja bëhen, ju shërbejnë qendrave të bashkive të mëdhaja, po, se mbledhin edhe paratë e këtyre zonave periferike edhe investojnë nëpër qytete dhe në zonat afër qyteteve të mëdhaja. Ato periferike fiken siç janë fikur fshatrat e Shqipërisë cep e në cep, duke u boshatisur, duke u shkretuar, duke u katandisur shkollat pa nxënës e pa fëmijë, ku ka më shumë mësues se nxënës. Këto ju mund t'i thoni sa doni, edhe zotërinj që keni përballë kolegët, po njeri nuk është se i beson, se njerëzit i kanë sytë në ballë edhe shikojnë, e po e përjetojnë vetë çdo ditë të punës. Po nëse keni mundësi të më përgjigjeni shkurt, të shkrijnë bashkitë apo jo? Dhe nëse ju jepen financimet e duhura, a i realizoni dot këto kompetenca dhe këto shërbime apo jo? Kaq.

Arbjan Mazniku:

Ka një koment tjetër, një pyetje tjetër më të zgjeruar nga një nga kryetarët? Okej, nëse jo, po.

Vasil LLajo:

Faleminderit, zoti kryetar. Jemi duke diskutuar në lidhje me një reformë të re që duan të bëjnë, duke e krahasuar me një reformë të vjetër dhe duke e krahasuar dhe akoma me një reformë më përpara të 2004-s. Në çdo kongres të mjekësisë që ne kemi marrë pjesë së bashku me profesor Dritan Shehun, kemi parë të të gjitha ato që ne flasim, raportet që bëjmë, i paraqesim me slajds. A do të ishte e mirë në këtë komision të vendosim këtë rregull, këtë kulturë dhe këtë edukatë, që neve t'i paraqesim diferencat midis një reforme me një tjetër, anët pozitive dhe anët negative midis këtyre reformave, pa qenë nevoja të mbajmë ato barrikatadat tona politike që patjetër janë të respektueshme, se jemi në funksion politik, por në këtë është i vetmi komision që duhet të dominonte funksioni administrativo-teknik dhe të dëgjoheshin kryetarët e bashkive, por duke bërë komisioni vetë një përjasje më të mirë në lidhje me paraqitjen që thashë të diferencave midis reformave dhe ku duam të shkojmë. Dhe po, këtë do të ishte shumë e mirë që kryetarët e bashkive të kishin një tabelë në të cilën do ta paraqisnim me slajds, me videoprojektor, dhe ne do të kushtonim kohën e diskutimeve të pavlefshme, të cilat ne mund t'i bëjmë si komente në fund. Por dhe pyetja ime është: a mundet një ditë kryetarët e bashkive të katërt që janë të na dërgojnë një informacion shkurt, saktë? Jemi me këtë reformë të 2014-s, si unë e mbështes që është një reformë e cila është e suksesshme. Patjetër që do ndërhyrje, sepse çdo organizëm i gjallë i cili merr frymë duhet të adaptohet me situata të reja, se dryshe, siç thotë edhe Arvini, ajo që dëshiruar të zhduket. Dhe mbi të gjitha, duke mëshuar më fort që për Bashkinë e Dropullit, falë asaj reforme, hyri si Bashkimi Minoritar dhe sot që ne duam të hyjmë në Europë, jemi përpara zbatimit të Konventës së të Drejtave, jo vetëm të njeriut, por dhe të minoriteteve. Pra, e kemi kaluar këtë fazë të cilën ne i themi Europës. Këtu jemi, na pranoni. Pra, do të thosha që në qoftë se ekziston mundësia që kryetarët e bashkive të dërgojnë një material në tip krahasues. Faleminderit.

Luçiano Boçi:

Tani, një ndërhyrje të përsëritur, në fakt, në atë çka kam thënë. Nuk kemi këtu për të bërë krahasim 2014-ën me 2005-ën. Jemi në reformë territoriale, sepse ka shumë arsye për 2014-ën, për objektivat që nuk ka realizuar, për kontradiktën midis funksioneve, kompetencave dhe autonomisë financiare, për çështjet e shërbimit, të mos përfaqësimit, të distancës së madhe me qytetarin. Dhe kjo është arsyeja që jemi në reformë. Në qoftë se do të ishte reformë funksionale, siç u parashtrua pak më parë këtu, nuk kishte nevojë fare për opozitën. Në qoftë se do të ishte reformë strukturore, nuk do të kishte fare nevojë për opozitën. E bën qeveria. Thashë, ka dokumentat e veta, iniciativat e veta, ka planin strategjik të vetin për pushtetin lokal, ndërsektorial, për të harmonizuar legjisllacionin, për t'i përputhur, për të mos ketë konflikte, që të mos ketë konflikte, se nuk ka nevojë për opozitën në këtë rast. Është reformë territoriale që duhet të rikthejë shërbimin tek qytetarët nëpërmjet rritjes së funksionalitetit të pushtetit vendor. Këtë duhet të pranojmë. S'do bëjmë panoramën e sa bukur u bë në 2014-ën, po nuk që e ka dhe aq bukur, se do ta bëjmë një çik, do i shtojmë ca lule, po s'është kjo. Po bëjmë reformë. Një reformë bëhet për të rregulluar gabimet. Nuk ka reformë, është shumë e mirë, por do e bëjmë akoma, akoma më të mirë. Tani mos bëjmë shaka midis nesh, të paktën, t'ia kursejmë njëri-tjetrit këtë arsye pse jemi në komision. Të vazhdojmë tani me pyetjet. Po, zoti Shehu.

Vasil LLajo:

Më fal, zoti kryetar, doja të bëja një ndërhyrje.

Luçiano Boçi:

Jo, zoti Mziu, fjalë për fjalë.

Vasil LLajo:

Jo, zoti kryetar, doja t'ju bëja një ndërhyrje, më falni, sepse kur themi të bëjmë krahasimin e reformave, themi ku duam të arrijmë dhe patjetër që do të shkruajmë atë që është e nevojshme për të arritur. Juve mos e çoni në gjysmën e fjalës time që tha të bëjmë krahasimin e 2004-ës me 2014-ën dhe të mburremi apo të turpërohemi për atë çka është bërë. Ne themi objektivat ku janë, duke i krahasuar me 2014-ën. Pra, po t'i kishim në një tabelë dhe objektivat, ato që thoni ju që unë jam shumë dakord, por t'i kishim aty, do të kursenim kohën edhe njerëzve që na dëgjojnë, edhe kryetarëve të bashkive, edhe njëritjetrit. Faleminderit.

Luçiano Boçi:

Do shkojmë te objektivat, doktor, nëpërmjet dëgjesave, parashtrimeve.

Prandaj do e vazhdojmë. Po, zoti Mziu.

Xhelal Mziu:

Faleminderit. Më vjen mirë që Qarku i Gjirokastrës ka shtatë njësi vendore. Në këndvështrimin tim, është zgjidhja më e mirë që është dhënë një qarku, pavarësisht se është pothuajse qarku më i vogël ose pas Kuksit, dhe ka shtatë bashki. Madje, në këndvështrimin tim, do të doja që të kishte dhe më shumë. Bie fjala Zagoria. Mund të ishte, të paktën, nga disa komunikime që kemi patur, po themi, me qytetarët e asaj, edhe në reformën e dy vite më parë që nuk u bë e mundur. Së dyti, shoh një element nga shtatë bashki që janë këtu, dy bashkitë më të mëdhaja, siç është ai i Gjirokastrës dhe ajo e Përmetit. E Përmetit refuzon për të ardhur dhe nuk dërgon as deleguar, ndërsa Gjirokastra dërgon një deleguar. Pra, çfarë do të thotë që kryetarët e bashkive të mëdha janë propotentë? Çfarë do të thotë që, siç ndodhi dhe me kryetarin e bashkisë së Elbasanit, e njëjta gjë ndodh, po themi, dhe me Gjirokastrën dhe me Përmetin. Dhe ndërkohë shohim kryetarë të bashkive të vogla, të cilët janë totalisht të angazhuar dhe në debat që bëjnë. Pra, prevalon interesi i bashkisë sesa pjesa politike. Mbaj mend që reforma edhe njëherë e 2014-ës kishte si qëllim për t'i shërbyer qytetarëve, për të kursyer ca para që shkonin kot për pagat dhe për të rritur, në fakt, atë çfarë i takon qytetarëve: investimet dhe shërbimet. Po a ka ndodhur, në fakt, kjo situatë? Absolutisht, jo vetëm që s'ka ndodhur, por ka shkuar në kahjen e kundërt dhe unë po e shoh, po jap vetëm dy tregues, po themi, investimet. Kur kishim 373 njësi vendore, shkonin për investime 37.5% e buxhetit të tyre. Sot shkon vetëm 18%. Pra, dy herë më pak morën investime. A paska qenë efiçente? Jo. Pastaj, a e ka rullin bashkia, apo e kanë cinguar në investime, apo janë rritur, po themi, administratat fiktive? Këtë besoj që gjithsecili e di. Po them, po prapë dhe për administratën, kishte vetëm 31.5% të buxhetit që shkonin për punonjësit dhe do kursenim dhe ato 8 milionë euro, por që do të thotë që duhet të ulej ky 31.5%. Po ku ka shkuar? Ka shkuar sot në 47.5% ose 15% më shumë. Pra, ne kemi sfiduar rregullat ose ekonominë e shkallës. Zvoglohen bashkitë, në vend që të ulen kostot, rriten kostot. Vetëm në Shqipëri ndodh kjo, në asnjë vend tjetër nuk ndodh. Dhe po prapë, për të qenë koherent, të shtatë bashkitë që ka ky qark, nga këto tre bashki e kanë rritur fondin e pagave dhe sigurimeve shoqërore tre herë më shumë sesa në vitin 2015 dhe katër bashki të tjera katër herë më shumë. Çfarë do të thotë që ka një angazhim maksimal për të rritur administratën dhe jo për të rritur shërbimet dhe për të rritur investimet. Dhe jam absolutisht i bindur që asnjëri prej jush nuk i merr kështu me dëshirë, por unë jam i bindur që ka një qasje politike për të rritur, për ta përdorur pushtetin vendor, po themi, si një shtojcë elektorale. Pyetja ime është: A do të ishte më efektive që për çdo bashki të kishte një numër të kufizuar? Madje,

të vendosej dhe limit. Ne vendosim limit, po themi, për numrin e deputetëve, për administratën që vjen këtu. Për shumë vende të tjera, bashkisë ia lëmë këshillit bashkiak dhe kush është ai këshill bashkiak që nuk e shton, por mori urdhër nga lart? Dhe është absurde, po themi, që gati 50% e buxhetit të bashkisë të shkojë për administratën. Së dyti, akuzojnë disa nga bashkitë që kanë krijuar të ardhura vetëm 5% apo 6% me raportin. Ka dy gjëra. E para, mundet që Qarku i Gjirokastrës mund të ketë qenë dhe pak i favorizuar nga qeveria dhe i ka dhënë më shumë investime dhe ngelet minorancë mbështetja që ose kontributi i saj. Së dyti, unë do të them që nuk është puna e dobët e bashkive për të mbledhur të ardhura. Më thuaj mua çfarë të ardhurash ti mund të mbledhësh në Këlcyrë, apo në Memaliej, apo në Libohovë, apo kush janë ato bashkitë e vogla? Sepse aq biznese kanë, por e ka zgjidhur bota. Së pari, nuk jep 1% të transferte të pakushtuar, vetëm 1% jepet dhe bashkë me ato të tjera shkon maksimumi 3%. Vendet e rajonit, vendi që mund të ketë përqindjen më të ulët, është 6-7-10%. Pra, janë gati 3 apo 4 herë më shumë sesa ju. Pra, mungon mbështetja financiare. Së dyti, nuk mund të pretendosh që Bashkia e Gjirokastrës të jetë me të ardhura si e Libohovës. Se ku mund t'i marrë në Libohovë? Ku ka, po themi, aktivitet? Ku ka turistë aq sa çka në Gjirokastrë? Po prapë, Europa e ka zgjidhur dhe jep një fond balancimi të gjitha bashkitë të cilat nuk kanë potencial ekonomik, sepse nuk kanë biznese, i jep një fond balancimi për t'i vendosur në pozita të barabarta, po themi, jo për të patur një hendek të jashtëzakonshëm dhe brenda qarkut tek të ardhurat që vijnë për shkak të të ardhurave të veta. A i merr pushteti vendor? Po prapë, pyetja tjetër: Të ardhurat që i takojnë? Nuk i merr! A merrni ju taksë kombëtare? Nuk merrni taksë kombëtare! A merrni ju mjaftueshëm, po themi, financim nga delegimi i kompetencave? Absolutisht nuk i merr! E tha njëri prej jush që nuk mjaftojnë! Pra, ky është një shqetësim që ju duhet ta thoni, sepse fundi i fundit ju jepni llogari për qytetarët që menaxhoni. Ju delegoni kompetencën dhe nuk mjafton. U tha nga një nga ju që ishin deleguar për 10 punonjës, por në fakt aty duhen më shumë dhe ju detyroni pastaj taksat e qytetarëve për t'i përdorur për këto funksione të deleguara pa shoqërim financiar. Tjetër, ju ju është cënuar autonomia. A do ishit dakord ju me këtë? A merrni ju fonde nga grantet konkurruese, siç ka qenë një praktikë më përpara? Tani, këto financime vjen e i bën Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Në vend që t'i bënit ju, ju jeni personat të cilët më mirë se askush tjetër e bën. A do ishit ju dakord me këtë që të vijë t'i bëjë Fondi Shqiptar i Zhvillimit ato rrugët e brendshme sesa të delegohej fondi tek ju, siç ka qenë praktikë edhe më përpara? A është normale, po themi, që ishte kauzë kadastra urbane? Sa të ardhura ju krijoni nga kadastra? Ju s'keni kompetencë! Ju edhe nëse doni të ndërtoni një objekt, po themi, arsimor apo në funksion të bashkisë, ju duhet t'i drejtoheni ministrisë për t'ju dhënë të drejtën e përdorimit të tokës në territorin tuaj. Në asnjë vend të botës nuk ndodh kjo dhe që duhet ne si komision, në bashkëpunim me ju, t'ju japim zgjidhje. Zgjidhje, jo zgjidhje politike, zgjidhje për qytetarët. A ishte e normale, po themi, për ujësjellësat? Njëri u jep 100%, pastaj i rajonalizon, tani i ka bërë kombëtarë dhe ndërkohë kompetenca juaj është pothuajse 0, madje është rritur numri i atyre dhe për pasojë sjell një barrë ekstra që ju ndoshta detyroni për të përdorur të ardhura të tjera për të kompensuar fondin e pagave apo humbjet e ujësjellësit. A jeni dakord me këtë situatë që është krijuar? A jeni dakord ju që pushteti qendror dhe pushteti vendor janë dy pushtete të pandara, të më fal, autonome që s'kanë asnjë lloj lidhje kompetence dhe ndërkohë, po themi, kryeministri vjen në bashkitë tuaja dhe të gjithë Shqipërisë dhe thotë: "Do hiqet nënkryetari, sekretari i përgjithshëm, administratorët" dhe ju rrjesht imazhi i një kryetari bashkie atëherë bie për tokë, sepse thotë: "Komandohet nga lart" dhe nuk e bëni, po themi, atë rregullim të nevojshëm si duhet në taksën e mbledhjes së pasurisë. Shqipëria është në fund, po kush e vuan? Pushteti vendor! Ka informalitet? Ka centralizëm? Ku i keni kadastrat ju? Kadastrat, asnjëri prej jush nuk ka kadastrë. Në të gjithë vendet e rajonit, kadastra është brenda bashkisë. Është brenda bashkisë, i shërben qytetarit, ndërsa tani kadastrat janë

centralizuar në Tiranë, siç janë centralizuar sa, po themi, kompetencat tjera. Bie fjala, po e marr rastin që të jem korrekt, Qarku i Dibërës, po themi, drejtorinë arsimore e kanë në Durrës dhe më thuaj mua çfarë lloj marrëdhënie është kjo? Ndërkohë, vendet e tjera të rajonit dhe Kosova, arsimin parauniversitar e drejton pushteti vendor. Ndërkohë, shërbimi parësor është po prapë në bashkëpunim me pushtetin vendor. Qarkullimi rrugor urban i brendshëm është kompetencë e pushtetit vendor dhe këtu në Shqipëri nuk është. Kështu që zëri duhet ngritur dhe duhet rregulluar siç janë vendet e rajonit dhe siç janë vendet e Bashkimit European. Nuk ka asnjë lloj lidhje, po themi, politike se po thamë ne, domethënë, është zi dhe po tha mazhoranca, është bardhë. Ne nuk kemi nevojë, po themi, ta shpigram rrotën, mjafton për të parë eksperiencën e vendeve të Bashkimit European. Ne jemi rekord, po prapë që ju ta dini, jemi rekord përsa i përket numrit të popullsisë për njësi vendore. 6 mijë e ka Europa, 70 mijë e kemi ne. Nëse i referohemi faktit sa kemi këtu, 40 mijë prapë do të thotë që jemi, ia kemi kaluar Europës dhe prapë, dhe prapë qasja, po prapë 4 milionë e 200 mijë, në qoftë se jo 4, po prapë 4 milionë e 200 mijë, 70 mijë bien. Po unë i heq ato që kanë ikur jashtë, bien tek 40-ta, pra shkon në favorin tuaj. Pra, decentralizimi sot është një sfidë e Bashkimit European për të shkuar sa më afër qytetarëve. Përdor instrumenta, ju jep kredi, ju jep rroga që të mos shpopullohet. Në fakt, është populluar dhe kur thuhet që është populluar, po themi, Gjirokastra apo Tepelena apo Përmeti, Vajhalli, po themi, zonat e tjera, nëse do t'i shkonim sa më afër, normalisht do të kishte mundësi më të mira, po themi, për t'i mbajtur qytetarët, për të zhvilluar bujqësinë, për të patur arsimin, për të patur shëndetësinë dhe ndërkohë për ta zvogëluar apo amortizuar eksodin që ndodh. Unë nuk po zgjatem më tej, por do të dëshiroja nga gjithsecili prej jush ta shohë jo në aspektin politik, por ta shohë në aspektin e asaj për të cilën është votuar një kryetar bashkie për t'i shërbyer me atë çfarë duhet dhe ndërkohë qeveria nuk ka nevojë për të treguar se sa babagjana ose bujara është ndaj pushtetit vendor. Shif referencat e rajonit dhe të Bashkimit European dhe jepi. Po prapë, u tha pak më përpara, bashkitë e vogla nuk kanë kapacitete. Si është pa të kesh kapacitete? Nuk do të kishte kapacitete kur kishte një nivel me 3 nivele, po themi, paga. Sot është unifikuar paga. Pra, një jurist paguhet unike në të 7 bashkitë tuaja edhe një inxhinier dhe kush është ai që nuk vjen? Por nuk është problemi i burimeve njerëzore, problemi po prapë ngelet administrata e fryrë që është tejkalon çdo lloj reference në rajon dhe në Evropë. Faleminderit!

Ermal Elezi:

Po! Po se pikërisht për këtë dua që të mos ndodhi. E kam paraqitur disa herë si shqetësim, shoh që vazhdon seancat dëgjimore janë që ne të dëgjojmë, jo të na dëgjojnë, se po mbajmë leksione të hapura. Atëherë i kemi thirrur, i kemi hequr nga puna, i kemi thirrur nga Gjirokastra, kanë ardhur nga larg, i kemi sjellë që të na dëgjojnë. Ne me njëri-tjetrin mund të flasim çfarë të duam. Ju lutem, duhet moderuar, zoti Boçi e kërkoi dhe nga ju, duhet moderuar koha që të bëhet e arsyeshme që ata që kanë ardhur që t'i dëgjojmë të flasin më shumë se ne. Jo ne të flasim më shumë se ata.

Luçiano Boçi:

Zoti Elezi, po dakord jam, por dëgjesa është për publikun, nuk është vetëm këtu se do të ishte dëgjese e mbyllur nga media, në qoftë se do të ishte provim ky që ne t'i pyesim, ata të përgjigjen dhe njëherë. Po patjetër, deputeti ka pyetje se bëri disa pyetje dhe ne nuk mund të ndërhyjmë tek mënyra se si e parashtron. Pastaj është dhe sqarimi i pyetjes pse po e bën pyetjen. Ai ka këndvështrimin si deputet, ndërkohë që kërkon, ndërkohë që kërkon se kështu ndodhi edhe me Klevisin. Kjo ndodh, po po e njëjta gjë është, e njëjta gjë. Po e di pse, sepse është, po e di pse është, se është instikti i deputetit. Jemi në komision, jemi në komision dhe kështu e gjykon. Kjo është ndërgjegjen e deputetit dhe

mënyrën specifike si e ka ai stilin e parashtrimit. S'mund të ndërhyjmë, ka njerëz që janë konçizë, ka njerëz që e bëjnë me parashtrim tashi. S'mund t'ia themi dot deputetit këtë gjë. Pastaj nga përfaqësuesit, nga përfaqësuesit e bashkisë, unë kërkova që në fillim të jenë të hapur, t'i shprehin mendimet e tyre. Tani rrinë të ngurtë, të japin ndonjë përgjigje të shkurtër, mos bëj gabim këtu, mos e hedh këmbën në drasht kalbur. Tani nuk shkon kjo punë dhe detyrohemi ne pastaj të bëjmë gjithë këto parashtrime për të dëshmuar të vërtetën para publikut, se duhet e vërteta. Për këtë jemi në komision. Faleminderit!

Xhelal Mziu:

Për procedurë, po të lutem. Së pari, së pari, së pari, po marr shkak nga dy komunikime që u bë, që u bë. Një komunikim që u bë nga zoti Mazniku pak më përpara dhe kuptohet dhe nga zoti Elezi se të njëjtën linjë kanë. Kush ishte qëndrimi juaj? Ne si komision tani duhet të dëgjojmë ato. Kot një pyetje, ne si komision i posaçëm i reformës territoriale që jemi me të drejta të barabarta, pavarësisht se ju jeni dy bashkëkryetarë, ku e keni marrë atë të drejtë ju që vetëm ju duhet të drejtoni dhe duhet të dëgjojmë ato edhe kur dilni nëpër qarqe? Vetëm ju jeni dhe ne presim, domethënë, se çfarë do të thotë, po themi, komisioni apo oreksi i një personi se zoti Elezi harroi që e mbajti vetë fjalën nja 20 minuta. Kur flas unë, ju duken 20 minuta dhe e sfidoj zotin Elezi ta nxjerrim fjalën time nëse secila prej tyre nuk ka qenë referencë dhe mungesë kompetence për pushtetin vendor në raport me 2015-ën. Nuk ishte diskutim politik, ishte profesional në lidhje me problematikat që ka pushteti vendor, po themi, pa dallime politike që duhet të vendosim gishtin dhe t'i dërgojmë tek standardi. Nëse nuk i dërgojmë tek standardi i Bashkimit European, të paktën t'i dërgojmë tek vendet e rajonit. Kështu që të paktën lëreni që të kthejnë ndonjë përgjigje nga ato që unë bëra.

Arbjan Mazniku:

Zoti Mziu, meqenëse më drejtuat një pyetje, kemi dakordësuar si komision me dinamikën dhe vështirësinë që ka komisioni me anëtarë të barabartë, por kemi dakordësuar një axhendë. Në axhendë kemi dakordësuar një parim që është një ndër dokumentat dhe një ndër mekanizmat kryesorë të parlamentarizmit, që është dëgjesa me grupet e interesit. Në rastin konkret, grupi i interesit janë kryetarët e bashkive. Koncepti i dëgjesës nisat nga ideja që çështje të caktuara që janë të ardhura të komisionit, jo kryetarë të komisionit, unë e kam rezervuar veten, nuk kam bërë unë pyetje. U bë dëgjesa e tretë sot, unë vetë s'kam bërë asnjë pyetje që mund të kisha dhe kisha pasur shumë pyetje. Anëtarët e komisioneve bëjnë pyetje, ngrejnë çështje dhe pala që ftohet për të qenë pjesa e dëgjuar ka mundësinë të shprehë mendimin dhe opinionin e tyre. Shqetësimi im është që sot kemi tani që flasim rreth 2 orë e 20 minuta në dëgjes. Nga këto, më shumë se 2 orë janë shpenzuar nga fjalime të gjata dhe jo pyetje nga deputetët e opozitës. Në qoftë se do të bëjmë dëgjese apo debat me njëri-tjetrin, unë jam shumë i hapur kur doni të lëmë një mbledhje pa të ftuar, me media apo pa të ftuar, dhe flasim ne me njëri-tjetrin 3 ditë. Nuk kam asnjë problem unë që ne të flasim, pra nuk kam unë asnjë shqetësim, nuk kam asnjë shqetësim, nuk kam unë asnjë shqetësim që patjetër që është. Të lutem se, o zoti Nxiru, ju dëgjova dhe nuk ju ndërpreva. Tani më bëre një pyetje, po të përgjigjem. Po ta lexoni dokumentin që kemi miratuar, është në dokument dhe kjo çështje dhe të gjitha vendimet që kemi marrë janë miratuar me dakordësinë dhe të bashkëkryetarit të komisionit. Tani dhe parimi i gjithës ishte i thjeshtë: ne bëjmë pyetje, kryetarët përgjigjen. Shqetësimi që kam pasur dhe vazhdoj të kem është do keni të gjithë kohën t'i thoni mendimet tuaja siç i mendoni ju, nuk ka asnjë problem. Jam shumë i hapur ndaj çdo mendimi, çdo kritike, çdo analize, çdo vlerësimi, nuk është ky thelbi i debatit. Shqetësimi që kam është që është mungesë respekti për kryetarët e bashkive që kanë ende detyrat që ne kemi folur vetë dhe s'i

mbyllim pyetjen. Kështu që do të doja ta ndaloja këtë diskutim, të kalojmë te përgjigjet e kryetarëve

Luçiano Boçi:

Ja të marrim edhe dakordësinë e zotit Nxiru se të flasim dy përfaqësues të qarkut edhe. Pa pyetje, besoj, nuk janë. Në respekt të axhendës që kemi në...

Arbjan Mazniku:

Në qoftë se... Atëherë, atëherë mund të përfaqësuesit e qarqeve kanë pyetje për të bërë, janë krejt ok t'i shtojnë pyetjet, t'i japin mirë, sepse kemi dhe... Mund ta bëni, do të dhënë përgjigje. Ok, vazhdojmë përgjigjeve. Pas përgjigjeve.

Bashkia Gjirokastrë (Artiste Koko)

Në vijim të asaj çfarë u pyet, u folëm me shifra konkrete dhe po i referohem shifrave konkrete. Që prej 2020-ës, që nga 2015-ta deri në 2020-ën, në administratën e Bashkisë Gjirokastrë janë të atashuara vetëm funksionet që u hoqën nga ish-komuna dhe iu bashkuan Bashkisë Gjirokastrë. Në 2020-ën, Bashkia Gjirokastrë i shkroi të gjitha njësitë e saj të varësisë dhe e ka bërë një njësi të vetme shpenzuese dhe të gjitha ato njësi varësie që i kishin administratën në varësi të saj, por me kode funksioni të veçanta, iu bashkuan administratës së Bashkisë Gjirokastrë. Dhe që prej 2020-ës deri në momentin që unë po relatoj sot, nuk ka asnjë shtesë të administratës, të numrit maksimal të punonjësve në Bashkinë Gjirokastrë. Është një nga bashkitë që ka zero detyrime financiare. Pavarësisht se trashëgoi detyrime financiare nga ish-komunat, arriti që deri në 2020-ën mos të kryente investime strategjike, t'i mirte ato nga grantet konkurruese dhe të arrinte të shlyente të gjitha detyrimet e përparmëruara që iu atashuan buxhetit. Nga ajo çfarë u relatua dhe në fund fare u bë në pyetje, u kthye në pyetje, doli qartë që fuqizimi i bashkive arrin t'i japi shërbimet më afër komunitetit. Kjo e thënë nga ju. Për sa u përket fondeve, e thashë edhe gjatë gjithë diskutimit, por e theksoj që kemi nevojë për rishikim të transferteve të pakushtuara. Transferten e kushtuzuar e kemi marrë nëpërmjet granteve konkurruese. Më lejoni që t'i referohem njëësive administrative konkretisht. Njësia administrative CEPO, në momentin që është bashkuar administratës së Bashkisë Gjirokastrë, ka pasur fondet më të larta të njëësive administrative, por i paraqiti Bashkisë Gjirokastrë në pasuritë e veta financiare borxhin më të madh ndaj ndriçimit elektrik. Njësia administrative Lazarat, nga të ardhurat e veta, ishte njësi administrative ish-komuna me të ardhurat më të larta të veta, por deri në 2020-ën, Bashkia Gjirokastrë shlyente detyrimet e prapambetura për sigurimet shoqërore. Kjo të papaguara. Në këtë kuadër, duke qenë se nga diskutimi nxori në pah edhe një problematikë tjetër, është në momentin që reforma territoriale do të konceptohet në një format që do të dalin në versionin përfundimtar, duhet të merren në konsideratë dhe mënyra se si funksionet do t'i jepen bashkisë apo do të atashohen ato te pushteti qendror. Sepse flasim shumë për reformën territoriale, por deri në këto momente nuk u fol në raste konkrete dhe shifra konkrete. Kemi buxhetin më të madh, kemi buxhetin më të madh se çfarë e kemi pasur për pagat, sepse falë vendimeve të Këshillit të Ministrave, administrata mund të vlerësohet sot njësoj, një specialist i Bashkisë Gjirokastrë me një specialist të një bashkie që është më e vogël dhe pikërisht kjo. Unë, unë, unë e nisa që nga momenti, që nga 2015-ta, si ka ardhur rritja e fondit që të vlerësojmë? Po, po, flasim, flasim teknikisht dhe profesionalisht. Aman, rritjen e fondit të pagave nuk mund ta analizojmë vetëm duke parë shifrat që në vitin 2020 ka qenë një milion, po them, dhe në 2026 në dy milion. E krahasojmë atë, e krahasojmë atë me numrin maksimal të administratës së bashkisë, nëse ka pasur fryrje të numrit të maksimal të

bashkisë apo nëse nuk ka pasur, sepse rritja e fondit të pagave ka ardhur falë dy VKM-ve të cilat kanë rritur vlerësimin e administratës publike në pushtetin vendor, sepse deri në 2023-ën, administrata e pushtetit vendor ka qenë më pak e vlerësuar. Dhe për sa u takon pastaj pjesës së menaxhimit të fondeve për nga bashkia, patjetër që nëse bashkisë i jepet pushteti i lekur, atëherë edhe shërbimi është më afër komunitetit, sepse më përpara një zjarrfikëse të shkonte në fshatin më të largët të Bashkisë Gjirokastër, i duhej gjysmë ore, sepse nuk ishte infrastrukturë rrugore. Sot e bën për 10 minuta. Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Ok, dikush nga kryetarët e tjerë ka një përgjigje për pyetjet e zotit Mziu? Po, zoti Toli.

Dhimitraq Toli:

Bashkia Dropull nuk ka detyrime, nuk dua ta them prapë se është e lista e Ministrisë së Financave, siç e tha dhe zoti deputet. As funksione i arritur, funksione, dhe nuk kemi rritje të numrit të administratës, por janë rritur funksionet, janë rritur shërbimet, edhe Bashkia Dropull është në nivelin që duhet të jetë. Ato mund t'i keni dhe te regjistrat e Ministrisë së Financave që janë të gjitha. Tani, për diskutimet e tjera për ndryshimet, ne i diskutuam. Zoti deputet nuk kishit këtu që në fillim. Unë nuk besoj pse diskutojmë të njëjtat pyetje çdo deputet. Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Ka dikush tjetër nga kryetarët? Ok, kishte për të kaluar. Zoti Mala e ka pyetjen. Ju lutem t'i mbajmë sa është e mundur shkurtër, sepse jemi në kohë dhe kemi dhe pasion tjetër për 30 minuta.

Agron Malaj:

Patjetër. Unë kam dy pyetje. E para, bashkitë e vogla kanë kapacitetin të mbulojnë gjithë shërbimin territor? Duke filluar me pyet rrugët, kanalet vaditëse, shërbimin arsimor, transportin me radhë. E dyta, dëgjova pak për rolin e administratorëve, se u ktheva pak pas në kohë në vitin 2013, 2011, 2012 e me radhë, ku ish-komunat të asaj kohe, 373 ish-komuna të famshme, ishin si vendore në atë kohë, që jo më pak na lanë borxhe rreth 80% të buxheteve të bashkive pas ndarjes së re territoriale, ku nuk kishin kapacitete që të paguanin dhe pagat e punonjësve dhe të këshilltarëve që kishin në varësinë e tyre, në përbërjen e tyre, dhe jo më të të bëjnë investime në territor, ku e dimë shumë mirë se sa fuqi kanë pasur komunat në atë kohë, ku të paktën 70% e infrastrukturës rrugore rurale e bashkive, vetëm këto vitet e fundit, është rehabilituar dhe asfaltuar me radhë. Ndaj dhe diçka tjetër, kanë kapacitet, kapacitetet nuk janë të lidhura me prokurimet, kapacitetet janë të lidhura me mundësitë e shërbimeve në territor apo për t'iu përgjigjur projekteve të ndryshme, jo vetëm në projekte, në miratimin e projekteve apo përbërjen e projekteve, por edhe në plotësimin apo në zbatimin e këtyre projekteve. Këto kisha. Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit. Kryetarët, cili ka një përgjigje? Ndaj kujt ishte? Ka një? Po. Po, zoti Hide.

Leonard Hide:

Në lidhje me pyetjen, ajo ç'kemi patur të nevojshme që të bashkitë e vogla kanë nevojë për burime njerëzore. Ka shumë shërbime që edhe me atë kapacitet që ka, nuk mund t'i

mbulosh dot të gjitha shërbimet bashkë. Të flasim edhe për pjesën e menaxhimit të mbetjeve, qoftë edhe për pjesën e ujitjes, qoftë edhe të pyjeve. Por kjo gjithmonë nuk do të thotë sepse ne performojmë keq apo nuk bëjmë punën, punën në mënyrën që i takon një administratori. E them këtë sepse pavarësisht se janë burimet e pakta, nuk do të thotë që këto bashki të mos ekzistojnë. Mund të ketë diçka, një qasje tjetër, qoftë në mbështetje financiare, qoftë edhe në mbështetje me. Siç ne po operojmë me Bashkinë fqinje me Dropullin, të pjesën e mirëmbajtjes së rrugëve rurale, pjesës që. Bashkëpunimin që operojmë bashkë në pjesën e mirëmbajtjes së rrugës Pogon-Zagorie, që na lidh ndërhyrimit të dyja bashkë.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit. Një nga kryetarët e tjerë? Po, zoti Mali.

Albert Malaj:

E çfarë doja të thoja është që ne ndoshta s'kemi kapacitete për të bërë kanale vaditëse apo këto aplikojmë te Ministria e Bujqësisë, por vetë ne me forcat dhe mjetet që ne kemi, i mirëmbajmë të gjitha ato kanalet që kemi. Në lidhje me infrastrukturën, prapë me mjetet dhe me njerëzit që ne kemi, mirëmbajmë të gjitha rrugët e rrugët e fshatrave. Për shembull, Bashkia me Malia i ka 53 fshatra. Këto fshatra pastaj ndahen në lagje, pse jo edhe shpirtira të veçuara, e gjithandej. Ne jemi çdo ditë në funksion të tyre dhe i mirëmenaxhojmë çdo që ndahet. Ajo çfarë doja të thoja është që duhet të na rriten fondet. Ka shumë bashki që ndoshta s'kanë nevojë fare për buxhet nga shteti, sepse kanë plot të ardhura. Ne nuk kemi, nuk kemi, nuk kemi lekë, jo se s'kemi kapacitetet që ne t'i shërbejmë njerëzve. Këto.

Luçiano Boçi:

Po, faleminderit, zoti Shehu.

Tritan Shehu:

Faleminderit. Unë dëgjova komentet që u bënë. Të them të drejtën dhe e shoh që kryetarët e bashkive ose nuk e njohin realitetin fare, ose nuk duan të thonë të vërtetën. Ky është ajo konkluzioni im nga këto që diskutova deri tani. Vetëm i thurur në lavdi dhe lavde reformës territoriale të 2014-ës, por ama pa thënë pse. Shiko, kush është? Unë kam këtë pyetje ndoshta të përgjithshme. Që kë konsideroni treguesin kryesor të mbarëvajtjes së një pushteti lokal? Kush është? Është që, t'ju përgjigjem unë, është që të bëjë që qytetarët të jetojnë sa më mirë gjithmonë në atë vend, në atë hapësirë, ta ndiejnë veten sa më mirë, të vazhdojnë të jetojnë, ai vend të zhvillohet, të rritet popullsia. Kjo është. Ky është treguesi. Treguesi juaj, zoti Ndashe, është i lidhur me nivelin e qytetarëve, jo vetëm juaj, edhe i qeverisë. Unë nuk ju vë faj vetëm juve, por unë ju vë faj juve se nuk thoni të vërtetën, se nuk keni guxim të thoni të vërtetën dhe këtë ju vë faj shumë. Pra, treguesi është kjo. Që qytetarët të rrinë, hajde të shikojmë qarkun e Gjirokastrës. Si ka ndodhur që nga 2014-ja tani popullsia e Gjirokastrës sa është ulur? 3.8% në vit ulët. E dini ju këtë gjë? Ku janë lindjet në Gjirokastrë? Janë më të ulëta në gjithë Shqipërinë. Si janë vdekjet në qarkun e Gjirokastrës? Më të larta në gjithë Shqipërinë. Ku po shkojnë të rinjtë? Si janë? Ikin të gjithë. Shkollat mbyllen. E keni të ditur ju vetë, shkollat po i mbyllen. Sistemi shëndetësor po mbyllet i tëri. Ekonomia ka rënë 40% prodhimi vektoral bujqësor. Nga? Ja u them unë tani. Nga 2000 kompani të regjistruara në Gjirokastrë, vetëm 30% merren me prodhim

real, të tjerat vetëm me administrim, me turizëm, me gjëra të tilla. Po sa paguajnë turistët në Gjirokastrë? Në qarkun e Gjirokastrës, 45 euro në ditë është konsumi. Minimal fare. Atëherë unë ju pyes, a e ndjeni veten përgjegjës juve? Në qoftë se nuk jeni ju përgjegjës, e vini në pyetje kush është përgjegjës për braktisjen e qarkut të Gjirokastrës? Për largimin e njerëzve nga sytë këmbët nga qarku i Gjirokastrës? Kjo është pyetja. Kjo është ajo që mund të them: indeksi i përgjithshëm që tregon gjithë mbarëvajtjen e punës. A e rrinë njerëzit? A jetojnë njerëzit? Apo ikin njerëzit nga sytë këmbët? Kjo është, s'ka tjetër. Të tjerat janë fjalë. Në qoftë se që ju shtoni administratën, nuk rritet popullsia. Edhe këtë vit Gjirokastra ka shkuar në 16 administratë të bashkisë. Brenda këtij viti, ja them unë, por nuk rritet popullsia në këtë mënyrë. Krijohet, po, një grup patronazhistësh që po krijoni edhe i përdorni vetëm për zgjedhjet, jo për sepse nuk ka përgjigje kjo gjë me ndjenjën e qytetarëve ndaj njërive tuaja të administrative, po ikin qytetarët. Kur ikin qytetarët, tregon që gjithçka e madhe nuk funksionon. Thoni ju kush faj: tuaj apo i pushtetit qendror? Apo i përbashkët? Unë them i rrëshqit i përbashkët, e ta dini. Mendimi im. Nuk i thoni këto gjëra. Atëherë si mund ta zgjidhim ne çështjen? Pse? Sepse vetë reforma administrative e 2014-ës ishte e bazuar mbi dy elementë. E para, me një element mekanik: numrin e qytetarëve që s'ka lidhje. Ne kemi në Itali komuna me 1200 banorë, që nuk është institucioni, struktura territoriale që bazohet në zgjedhje, jo në administrative, që mund të quhet komunë, bashki. Ka ca parime mbi të cilat ndërtohet. Nuk shuhet sepse u ra popullsia, sepse popullsia kaq ka traditë, ka histori, ka prodhim, ka tipikat e saj. Kjo është, është shumë e gjerë. Nuk mund ta simplifikosh këtë gjë. Po e simplifikohet, shkatërrohet si e shkatërruam me atë reformë të shkatërruar. Dhe e dyta ishte koncepti Gerry Mendring. Ajo reformë u ndërtua përveç saj me konceptin Gerry Mendring. Kjo është. Koncepti Gerry Mendring është një nga shkatërrimet që shkatërroi këtë reformë, edhe në qarkun e Gjirokastrës. Këtu është. Dhe pastaj, po, rezultati i gjithë kësaj, edhe keqqeverisjes qendrore, nuk ia them vetëm ju, është braktisja e popullsisë. Kjo është, kjo është diagnoza, diagnoza këtu vihet. Pastaj shkaqet janë shumë. Lidhen me ju, nuk lidhen me ju, është tjetër gjë. Përgjigjuni këtyre pyetjeve: pse ka ikur popullsia? A mund të përgjigjet njeri direkt, të thotë mua pse ka ikur popullsia? E dyta, çfarë do bëni ju? Çfarë keni ju në strategjinë tuaj zhvilluese për të përditësuar popullsinë, jo për të ikur, për të rritur lindjet, për të ulur vdekjet, për të mbajtur të rinjtë? Shoh asgjë nga kryetari dhe zoti kryetar, kjo është reforma. Nuk shoh asgjë, sinqerisht po e them, asgjë të shkruar për këtë gjë. Nuk thanë asnjë fjalë për këtë gjë. Më thoni një gjë, nuk po qesh, po flas shumë seriozisht. Më thoni një gjë, si do bëni për mos ikur popullsia, për të kthyer popullsinë? Po ikën, vazhdon përditë, po ikën. Ore, si nuk ngritet njëherë zëri juaj kur zyrat qendrore të qarkut të Gjirokastrës shkojnë në lushnje, gjykatat shkallmohen, kur ai për një çertifikatë detyrohet të shkojë në Durrës dhe në lushnje? Si nuk dëgjova një kryetar bashkie të ngrihet e të thotë në një prodhim publik? Ato se ç'bisedojnë pastaj është tjetër gjë. Ore, çfarë po ndodh? A keni këtë guxim ta thoni këtë gjë? Kur qytetarët e thonë, ju jeni përçuesit e zërit të qytetarëve. Ju nuk e thoni. Vjen zëri te ju, ju e ndaloni atje. Pse? Unë kam një pyetje: pse nuk protestoni edhe ndaj këtij elementi? Braktisjes së qarkut të Gjirokastrës nga institucionet shpërbërjes? Pse nuk e thoni? Mund ta thotë njeri? Unë nuk besoj që nuk e kuptoni. Ja them shumë sinqerisht, jeni njerëz me eksperiencë. E kuptoni edhe keni informacionin se ju vijin informacionet nga qytetarët. Atëherë, pse nuk e thoni? Kjo është pyetja e madhe dhe mbi këto baza duhet të parë dhe reforma e re që të bëhet. Kam një pyetje për kryetarët e bashkive, se dëgjoj gjithandej që thonë: "Jeni dakord të bashkohet Kërçyra me Përmetin?" Ta thonë këtu, janë apo s'janë dakord? A mund ta thotë dy kryetarë të bashkive? A janë dakord të bashkohet me Malia e me Tepelenën? Hajde, thojeni. Në qoftë se jeni dakord, thoni tani. Po, ta dëgjojnë dhe qytetarët, se kjo do përmirësojë, thoni. Kam pyetje direkt për kryetarët e bashkive: A jeni dakord? A jeni dakord që Dropulli të bashkohet me Finiqin? A jeni dakord? Ma thoni këtë gjë. Në qoftë se s'e thoni që s'jeni dakord, ngrini zërin deri në kupë

qielli dhe ngriheni, se mbroni të drejtat e qytetarëve. Ma thoni këtë gjë. Ne thamë që Dropulli. Nuk jemi dakord. Ja, të mbaroj unë, të mbaroj unë. E the ti, e dëgjova, ti e the, po. Prandaj, a jeni dakord me këto gjëra? Në qoftë se s'jeni dakord me këto, atëherë kjo bie ndesh edhe me atë që bëri në 2014-ën. Se shkak ai është, një nga shkaqet, jo i gjitha. Këto kisha, faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Atëherë, meqë s'mund të drejtohem dhe unë një moment, po, të lutem, po, një pyetje. Pyetje. Edhe t'i japim përgjigje.

Mirela Kumbaro:

Vetëm një pyetje. Thatë që administrata e bashkisë së Gjirokastrës është rritur me 16 vjet. Kam një pyetje për... Tani, unë në... Tha çfarë nuk tha, po më lër ta mbaroj. E po, kjo tani. Kam një pyetje për nënkryetarin e bashkisë. Është rritur administrata e bashkisë së Gjirokastrës?

Bashkia Gjirokastrë (Artiste Koko):

Absolutisht jo, nuk e di nga doli ky numri 16, sepse tashmë jemi një nga bashkitë pilot të buxhetimit mbi programet dhe të gjithë dokumentat janë të afishuar në faqen e bashkisë, faqen zyrtare të bashkisë dhe për më tepër në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe atje mund të bëni analizën nëse ka rritje të administratës në vite, kështu që kjo ngelet për sa kohë u tha publikisht, kjo ngelet në përgjegjësinë tuaj.

Arbjan Mazniku:

Patjetër, patjetër. Tani, t'i përgjigjem pyetjeve që kishte deputeti përpara se ta çoj. Kush nga deputetët, kush nga kryetarët ka një përgjigje? Për ndonjërin nga pyetjet që ishin si pjesë e kësaj. Ndaj dhe i lutem njerëzve që në vend që t'i kërkojmë njerëzve të bëjnë kështu pohime, po t'i pyesim në lidhje me punën e tyre, është më e thjeshtë të marrin përgjigje. Por po them unë një element, zoti kryetar, zoti deputet, meqenëse ngritët edhe si mjek me shumë eksperiencë, për arsye edhe profesionale, ju nuk ju takon që të bini pre e pohimit të famshëm edhe mjekësor, por edhe shkencor që dy fakte që kanë korrelacion nuk kanë detyrimisht kausalitet, nuk i shkakton njëri-tjetrin. Pra, diskutimi që madhësia apo funksionet e bashkisë kanë ndikuar në popullsinë është nga ana shkencore e paprovuar për një arsye shumë të thjeshtë, sepse lëvizja e popullsisë nga periferi drejt qendrave urbane është një fenomen evropian 60-vjeçar. Lëvizja e njerëzve nga zonat rurale drejt zonave urbane është një fenomen evropian 70-vjeçar. Evropa sot e ka njerëzit që jetojnë në zonat rurale nën 20%, e ka 18%. Shqipëria e ka 40%, e ka nisur historinë, jo ta mbaroj sonte, ju të ndërrova. E ka nisur historinë Shqipëria në vitet '90 me 70% njerëz në fshat, 30% njerëz në qytet dhe kishim një sistem neve, e kishim sistemin i cili i mbante njerëzit me zor në fshat, i mbante njerëzit me zor në qytet, i çonte, të punonte në miniera, i çonte, të punonte në fabrika, ku e vendosi sistemi. Zgjedhëm ne të ikim nga ai sistem dhe të zgjedhim një sistem që njerëzit të shkojnë atje ku e gjykojnë më të mirë për të shkuar dhe fakti që në mënyrë sistematike sot që flasim neve, Greqia, Italia, Franca, Gjermania, Zvicra, Suedia, vende që i kanë shërbimet në të gjithë territorin e tyre, vazhdojnë të humbasin njerëz nga periferia drejt qendrave dhe vazhdojnë të humbasin njerëz nga qytetet e vogla drejt qendrave të mëdha urbane. Kjo po ndodh me Parisin, me Milanon, me Berlinin që janë qytete që rriten, ndërkohë që edhe periferi e Gjermanisë, të Francës, së Italisë janë në rënie të popullsisë dhe të dhënat gjithashtu na thonë një gjë. Nga '89-ta

në 2001-shin, qarku i Gjirokastrës është pakësuar me 43 mijë banorë ose me 27%. Nga 2001-shi, në 2011-ën, kur kishim shumë bashki, kishim plot bashki, cepe bashki, cope bashki, ka humbur 40 mijë banorë ose 36% të peshës së vet, ndërkohë që nga '11-ta në '13-ën ka humbur 12 mijë banorë ose 60%, më fal, deri në '23-shin, nga '11-'23-shin, 12 mijë banorë ose 60% të peshës së tij, që do të thotë, po ta merrnim diskutimin nga ana shkencore, ka rënë. Po ta merrnim, i thonë, po ta merrnim numrin dhe analizën si thoni ju, do të thoshte që me sa duket bashkimi i bashkive e paska frenuar rënien e popullsisë, se ishte në rënie të madhe dhe e ka frenuar, po patjetër se nga 2001-shi, nga 2001-shi, në 2011-ën, në Gjirokastrë ka rënë me 36% popullsia dhe nga 2011-ta në 2023-shin ka rënë me 16% popullsia, që do të thotë, që do të thotë, unë, unë, dëgjo, unë nuk po e bëj, zoti deputet, zoti deputet, unë nuk e bëj gabimin që të them që ka një lidhje midis. Ngaqë u bashkuan bashkitë, ra, unë besoj që trendet, trendet botërore të lëvizjes së popullsisë janë trende të cilat kanë shumë faktorë, ku madhësia e bashkisë nuk hyn te këto faktorë dhe tentativa për të ngritur një dhe për të bërë politikë dhe populizëm me një argument që nuk qëndron, sepse e dëgjoj këtë gjë që vjen sistematikisht në 10 vitet e fundit. Zvicra ka humbur 10% të popullsisë nga zonat rurale drejt zonave urbane, 10% të popullsisë së vetë Zvicrës dhe nuk janë te situata që s'kanë shërbime në fshat, që s'kanë qendra shëndetësore dhe s'kanë rrugë. Kanë lëvizur për arsye të tjera që kanë të bëjnë me mënyrën se si jetojnë njerëzit në këtë shekull dhe gjërat që presin njerëzit dhe me lirinë që njerëzit kanë të lëvizin. Detyra jonë nuk është të merremi me këtë çështje, detyra jonë është të sigurojmë si i japim shërbime qytetarëve atje ku janë, atje ku duan dhe të sigurojmë që edhe Libohova, edhe. Dhe çështja që kam unë, problemi që kam unë është ky dhe kjo është pjesë e diskutimit që ne duhet të bënim me pyetje të prekshme dhe praktike. Bashkitë mbledhin disa të ardhura të veta, kanë të njëjtin normë, të njëjtin sistem mbledhjesh të ardhurash, të gjitha bashkitë kanë të njëjtat taksa, të njëjtat tarifa që unë mbledhin dhe i kanë vetë në dorë t'i mbledhin dhe patjetër dhe burimi i tyre është qytetarët që kanë territorin e tyre. Gjëja që na ndodh është kjo. Bashki të cilat, mesatarisht, çdo bashki shqiptare mbledh rreth 15 mijë lekë në vit për frymë. Bashkitë e vogla që janë me më pak se 10 mijë banorë, mbledhin 7 mijë e 100 lekë për frymë. Çfarë ndodh në qarkun që jemi këtu? Libohova mbledh 3 mijë e 300 lekë për frymë, më pak se gjysmën e mesatares. Kërcyra mbledh 1.6 mijë lekë për frymë, më 4 herë më pak se mesatarja e grupit të vet, e grupit të bashkive të vogla me më pak se 10 mijë banorë. Me Maliaj mbledh 2 mijë e 800 lekë për frymë, që do të thotë më pak se gjysma prapë të mesatares. Në ndërkohë, çfarë ndodh? Pavarësisht se Tepelena është, edhe Tepelena jo shumë e madhe, mbledh 7 mijë e 400 lekë për banor, që do të thotë mbledh njësoj sa që është mesatarja e bashkive me më pak se 10 mijë veta. Përmeti mbledh 8 mijë e 200 lekë, mbledh më shumë se mesatarja e grupit të vet. Gjirokastra mbledh 9 mijë e 300 lekë më shumë se mesatarja, kjo do të thotë që elementi i burimeve specifike dhe i mundësive që një territor ka për gjeneruar, se nuk po merren fare për të bërë as analizë, as element funksioni. Ore, më falni, dëgjo, një sekondë më, si ka mundësi, o Zoti? O Zoti Mziu, o Zoti Mziu, o Zoti Mziu, fole. Zoti Mziu, Zoti Mziu, folët dhe unë nuk ju ndërpreva absolutisht. Unë nuk kam folur, unë nuk kam folur kurrë, por unë kam moderuar takimin, nuk kam folur për çështjen, është hera e parë në të gjithë ditën që unë flas për çështjen dhe tani mbajta referate për mënyrën e funksionimit të mbledhjes, jo për temën vetvete. Është momenti i parë që unë po flas për mbledhjen, ju dëgjova. Në dorë është shtati, por bashkia e Shqipërisë në. Zoti Xhel Mziu, ju nuk abuzuat me shifrat, ju i morët shpirtin i shifrave dhe ti mund të sfidosh mua në çdo gjë, por jo në shifra. Tani, thelbi, thelbi, po të lutem, tani, të lutem, mos më hakëno tani, po të them, po të them, po ju them sërish, konkluzioni i përgjithshëm. Dhe ky duhet të ishte tema e diskutimit që do të bënim sot. Në vend që të bënim diskutime, diskutime dhe referate, diskutimi i mirëfilltë që duhet të bënim me kryetarët do të ishte ky: çfarë mekanizmash duhet të japim kryetarëve të bashkive që të

mbledhin më shumë të ardhura dhe në raport me të ardhurat që kanë, sepse argumenti jonë që kërkojmë në të njëjtën kohë autonomi vendore, vendimmarrje më të madhe autonome nga ana e bashkive për financimin, por pastaj themi ky s'ka lekë, s'ka të ardhura aty dhe të ketë autonomi vendore për taksat, për paratë që vijnë nga qytetet e tjera, nga territori tjetër, kjo nuk krijon dot autonomi vendore me të ardhura që vijnë nga diku tjetër. Autonomia vendore është e lidhur me kapacitetin që ti ke për të mbledhur të ardhura vetë dhe autonomia vlen edhe në shtëpi, e kemi thënë jetë e mot, themi dhe në shtëpi, i thotë kur vjen dhe kontribuon, ke më shumë zë. Dhe një familje. Jo, diskutimi nuk po merremi, nuk po merremi. O, si ka mundësi në momentin që një fjali s'ju pëlqen, po ke gënjyer ti sa ke dashur, ke gënjyer sa ke dashur dhe nuk të ndërpreva fare. 6 mijë banorë dhe ke thënë gjëra që s'kanë lidhje.

Xhelal Mziu:

6 mijë banorë për njësi vendore në vendet e Bashkimit Europian, ne kemi 70 mijë, ne jemi rekord të Eksodit.

Arbjan Mazniku:

Zoti Mziu, të lutem, me shifra, jo të lutem, ato letrat e patronazhimit që keni. Zoti Boçi, ju lutem, a mund t'i kërkonin anëtarëve të komisionit të mos ndërhyjnë? O Ermal, të lutem. Unë them mesatarja e Bashkimit Europian t'i bëjë përmendje. Në qoftë se, o Ermal, o Ermal, të lutem, o Nalbat, në qoftë se nuk do të biem dakord për një element bazik që kur flet një person kohën e vetë, mos ketë ndërhyrje të tjera, kjo çështje nuk është.

Xhelal Mziu:

Ti e trajton si kopsht privat, Po jo, mos si kopsht privat,

Arbjan Mazniku:

Ore, fole 10 minuta, s'të ndërpreu njeri. Në qoftë se flet një opozitist, nxjerr një hartim aty dhe prallis opinionin publik se je bashkëkryetar, që je bashkëkryetar, nuk e ke të drejtën ti që të lexosh letra të cilat nuk janë të vërteta. Por e fole sa deshe, ti the ç'a deshe ti, ti s'do të merresh me analizën ç'a the unë të vërtetën, ose nuk ta ka bërë njeri gjykatës së vërtetës ty, o Zoti Mziu.

Xhelal Mziu:

Nuk e vlerëson fjalën, kur flet opozita, t'ia lëmë fjalën kryetar, kur flet ti me ato hartimet, duhet të japësh fjalën.

Arbjan Mazniku:

Jam duke bërë unë fjalën time, unë i lashë të gjithë njerëzit të flasin, pasi folën të gjithë njerëzit.

Xhelal Mziu:

Abuzove me shifrat, vëlla, abuzove me shpopullimin e Shqipërisë.

Arbjan Mazniku:

S'të pëlqejnë shifrat?

Xhelal Mziu:

Po, 1.1 milionë kanë ikur në 13 ditë.

Arbjan Mazniku:

S't'i bëj dot shifrat siç ke qejf ti?

Xhelal Mziu:

Thuaja shqiptarëve.

Arbjan Mazniku:

S'jua bëj dot, as numrin e mandateve si keni qejf ju, as humbjet, as fitoret, s'jua bëj dot, ato janë fakte. Ato janë fakte, s'jua bëj dot unë ato. Unë do të bëj komentin që të gjithë të dinë dhe ta them pa hezitim, jo për Shqipërinë, por për të drejtën tënde. Faleminderit shumë, e vlerësoj shumë, këtë e vlerësoj shumë. Mund t'ia thoni dhe Zotit Mziu këtë? Dakord, patjetër, mund t'ia thoni Zotit Mziu që unë kam dhe të drejtën e fjalës edhe unë. Po ti ke drejtë të abuzosh me fjalën? Po ti ke drejtë të abuzosh me fjalën? Po janë, janë shifrat e mia ato? Të Ministrisë së Financave? Po. Ta jap unë, patjetër. Forward apo ta çojmë me email? Ok, ka dikush një përgjigje për çështjen që u flit? Përpara se zonja Pac. Po. S'm'u duk që kishte përgjigje, po. Po.

Tritan Shehu:

Faleminderit, një sekondë, një sekondë, zotëri. Po flas unë tashi, ajo është kryetari, unë e respektoj, e respektoj kryetarin. Në lidhje me atë që tha kjo zonja e Gjirokastrës, është në manualët zyrtarë, ka qenë 607 është bërë 623 numri i punonjësve. Hapni manualët, shikojeni. Së dyti, kam këtë gjë për të thënë, unë nuk mora përgjigje nga kryetarët e bashkive që përveç nga Dropulli. A janë dakord të bashkohet me Maliaj me Tepelenën? A është dakord të bashkohet Kërçyra me Përmetin? Ta thonë hapur. Dhe e dyta, a janë dakord me largimin e misionëve nga Gjirokastra dhe shpërndarjen e tyre në vende të tjera? Deri tani s'kam dëgjuar asgjë. Unë këto janë esenciale të pyetjes. Unë dua një përgjigje konkrete dhe të qartë nga kryetarët e bashkive. A janë dakord me këto lëvizje apo jo? A janë dakord me këto lëvizje apo jo? Sa për rënien e popullatës, ajo është diçka që duket, është e evidente, nuk ka. Ajo lidhet me rënien e ekonomisë, me të gjitha, nuk është kështu si thuhet. Por ama megjithatë nuk duhet të hyjnë, është një diskutim i gjatë ajo, lidhet me rënien e popullatës në Shqipëri në tërësi, nuk hyj është me atë gjë unë. Por unë kam këto pyetje shumë konkrete për kryetarët e bashkive. A janë dakord me bashkimin e Tepelenës me Maliajn? E para. A janë dakord me bashkimin e Kërçyrës me Përmetin? Përveç Dropullit, s'më dha njeri përgjigje. Dhe e dyta, a janë dakord me largimin e misionëve kryesore nga qarku i Gjirokastrës dhe shkuarjen tutje? Këtu dua përgjigje, në qoftë se do më jepni, në qoftë se s'më jepni, është e drejta juaj, thoni nuk kemi përgjigje. Unë prapë nuk them asgjë, unë mbrapyetjen vetëm, faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Ka ndonjë nga kryetarët që do të përgjigjet? Po, zoti Maliaj, zoti Maliaj.

Albert Malaj:

E kam nisur diskutimin tim në mënyrë kategorike, bashkimit, këtu sjellim zërin e qytetarëve të majtë edhe të djathtë, të cilët janë kategorikisht bashkimit, nuk duan që bashkia me Maliaj të shkrihet apo t'i bashkangjitet një bashkie, një bashkie tjetër. Në lidhje me largimet e institucioneve të tjera, kjo nuk varet dhe as na ka pyetur njeri as për spitale, as për buxhete, as për hipotekat që janë larguar nga, apo drejtoritë rajonale të cilat janë larguar nga qytetet dhe nga qarku.

Arbjan Mazniku:

Po, ka dikush një përgjigje tjetër para se t'i japim zonjës?

Luçiano Boçi:

Kam dhe unë qëndrim. Të më falni. Po, prandaj po e them. Po jo, po nuk ka pakuficë, e mori.

Bashkia Gjirokastrë (Artiste Koko)

Duket sikur po ndjesë, duket sikur po bëjmë replikë për atë në 16-tën, por besoj se në krye të herës u paraqita një informacion se si dhe kur është rritur numri i personalit. Besoj se edhe ka ai manual, shprehet qartë që numri i personalit është rritur para 2023-shit. Për sa i përket shpopullimit në Bashkinë Gjirokastrë, do të doja nëse ka ndonjë referencë apo ndonjë studim që shpopullimi i qytetarëve në Bashkinë Gjirokastrë ka ardhur si rezultat i reformës territoriale.

Luçiano Boçi:

Atëherë, në raport me shpopullimin, sepse është një temë e marrë, e rimarrë dhe do të jetë pjesë e debateve tona dhe ka një spekulim shumë të madh në mënyrën si parashtrohet. Ka studim shkencor, po e nis nga kjo e fundit, po ka studime shkencore nga organizata botërore, ka nga banka botërore, UNDP-ja që përcaktojnë që mungesa e shërbimeve, largësia e qytetarit nga qendra, mungesa e përfaqësimit në vendimmarrje politike ka bërë që qytetari ta braktisë territorin e tij. Kur nuk ka shërbim arsimor, ai fëmijë nuk e shkollon dot në fshatin e tij, se është mbyllur shkolla. Kur nuk ka shërbim shëndetësor, do largohet sepse do mjekohet ai në spitalin më të afërt dhe shumë shërbime tjera, kanalizime, ujësjellës, rrugë, shtëpie, sa të duash. Mungesa e këtyre shërbimeve e detyron që ai qytetar të mos ta dojë token e vet, shtëpinë që ka ndërtuar, shtëpinë e babait, gjyshit, katragjyshit, stërgjyshit dhe largohet. Dhe largimi këtu nuk është europian dhe zviceran, sepse kjo është turp ta themi këtu. Shqipëria ka humbur 1.2 milionë për shkak të emigracionit, ka një E përpara, E emigracionit e thotë censusi, nuk e thotë as Partia Demokratike dhe as Xhelali apo deputetët e tjerë të opozitës. Mua më vjen keq që zoti Mazniku spekulon me shifrat. I vetmi qark që ka rritje është Tirana, nga 2011-ta sipas censusit, dhe e dini sa është rritur Tirana? Vetëm me 40 mijë banorë. Në vitin 2011, po, po, po, është me census. Në vitin 2011, Bashkia e Tiranës kishte 557 mijë banorë, censusi. Në vitin 2023, 598 mijë banorë. Rritja është 40 mijë banorë dhe në vazhdimësi, dje ishim në Durrës dhe unë kisha shifrat. Durrësi ka humbur 13% të popullsisë së tij, nuk kanë lëvizur nga periferia në Durrës, është qarku i Durrës, se përndryshe do të ishte lëvizje migratore. Edhe Durrësi ka humbur një popullsi konsiderueshme dhe sipas censusit ka humbur 29 mijë banorë. Durrësi vetë, që është zona më atraktive, më turistike e Shqipërisë. Sa ka humbur Elbasani? 60 mijë banorë. Sa ka humbur Shkodra? 40 mijë banorë. Po ja pra, 40 mijë banorë, u plotësua Tirana me 40 mijë, sa kishte fituar. Ku kanë ikur këto? Ku qe ka Shqipëria përtej Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit? Ku është përtej

Shkodrës? Ku është kjo lëvizja migratore e famshme në thonjëza? Të spekulosh me kaq hapur, unë jam dakord me reagimin e Zotit Mziu dhe prandaj së ndërhyra. Në qoftë se jemi këtu, ne kemi sigurisht autoritetin të flasim, por mbi të gjitha kemi autoritetin për të ruajtur dhe mbrojtur të vërtetën. Në qoftë se e spekulojmë ne të vërtetën, po vaj, vaj me hallë, censusi, censusi, censusi. Unë shkencor, shkencor ti ndoshta e quan vetëm shkencat ekzakte, por ka dhe shkencë sociale, po, po, po më do ta sjellë meqenëse ti do studimin prej meje dhe dhe ju nuk sillni as shifrat, as shifrat, as relatimet e institucioneve qeveritare, se ka një muaj që i ka kërkuar, dy muaj që ka që i ka kërkuar zoti Elezi. Kur të mbaroj unë, po do, kur të mbaroj unë, meqenëse e dashke, por meqenëse, meqenëse ti nuk e paske formimin e duhur, që unë besoj se e ke, jo, po prit ta mbaroj, se formimin e duhur për të gjitha gjërat nuk e kemi. Që unë besoj se e ke, por ti vetë e refuzon, që ti mund ta konceptosh shumë mirë, se e marr drejtpërdrejt me pushtetin lokal, që një nga arsyet që zonat sot zbrazen periferike është mungesa e cilësisë së jetës. Nuk jetohet njësoj, jo njësoj, relativisht njësoj, se njësoj nuk mund të jetohet, por nuk ka kushtet minimale qytetare atje, se nuk ka arsye ta braktisë ai territorin, në qoftë se ka mirëqenie, në qoftë se fëmija i siguron shkollimin, në qoftë se prindi ka shëndetësinë, në qoftë se ka shërbime të tjera, në qoftë se ka kushte normale. Përndryshe, në qoftë se ai këto nuk i ka, ai ikën dhe ai ikën dhe ku ikën? Po ja pra, ke të dhënat, ai nuk po ikën as në qendër, s'po të vjen as në Tiranë, ikën jashtë Shqipërisë, sepse ky është problemi. Ne kemi probleme sigurisht në zonat rurale, në zonat periferike të një bashkie, ku kemi diskriminim dhe kontrast jete, por kemi dhe pasiguri si vend, si qeverisje qendrore. Po s'jemi këtu për të analizuar qeverisjen qendrore, këtu jemi për të analizuar qeverisjen lokale dhe po i marrim sipas territoreve. Dhe këto që përmenda unë janë të vërteta për çështjen e mbledhjes së të ardhurave. Po më në fillim, kur bëtë reformën e 2014-ës pa opozitën, përdorët të njëjtat fjalë: do shkëlqej, do realizoj shërbimet, do rris përfaqësimin, janë fjalët e juaja. Madje është shumë e qartë, qyteti ka thënë, kryeministri e thashë dje në Durrës, do ndihmojë fshatin, do e ndihmojë, do i rrisë nivelin ekonomik, do bashkëveprojnë. Prandaj u bëmë bashki edhe rurale, edhe urbane, sepse kjo ishte arsyeja dhe e bëjmë të madhe me qëllim që të ketë konvergim, të ketë fuzion. Ndërsa sot çfarë ndodhi? Fshatrat janë zhdukur, po zhduken toponimet, po zhduken fshatrat. Ka vetëm Pleq, që ju e dini shumë mirë, s'ka tri, s'ka tri në qytet dhe s'ka tri dhe atje. Dhe ju ishit shumë të qartë, përcaktuat funksione dhe harruat të vendosni burimin financiar. Po pse është lajthitje kjo? Përcaktuat funksione dhe harruat kompetencat, valli i harruat kompetencat. Që më jo, se e bëtë keq, dështoi, ishte hartë politike, thjesht politike u bë mbi numrin e votave, jo mbi bazën e nevojave të territoreve. Nuk ishte një reformë territoriale funksionale. Kur themi reformë territoriale, nuk është vetëm ndarje, më ndarja është administrative, merr lapsin dhe vendos: u nda territori. Jo, më territori duhet të ketë vazhdimësi ekonomike, duhet të ketë identitet edhe ekonomik-kulturor, tradicional, historik dhe një lloj funksionaliteti në vazhdimësinë e tij. Ne u prenë copat e funksionalitetit në mënyrë absurde dhe u nda ekonomia. Biles, ekonomia bëhet ndonjëherë konkurruese pa rezultat, se konkurrenca sjell zhvillim, por ne e ndamë territorin në formë të tillë që mos ketë konkurrencë. Dhe patjetër, më bashki ka bashki që nuk kanë mundësi të marrin taksa, të kenë të ardhura të larta, nuk kanë fluks turizmi, nuk kanë biznese, sepse sa bukur Bashkia e Gjirokastrës, po merrka, po pse ke njësi administrative njëlloj, i merrni të ardhurat ju, ke njësi më të largët nga taksat dhe tatimet, njëlloj siç i merr Gjirokastrë, që ke 2000 biznese. Jo, nuk i merr njësoj, sigurisht nuk i merr njësoj, por jo, fshati nuk e ndihmon qytetin, sepse të ardhurat dhe investimet janë përqendruar në qendër, se të ardhurat dhe investimet shkojnë për paga, se të ardhurat dhe investimet shkojnë për menaxhim mbetjesh, për funksione që kërkojnë shpenzime dhe që janë rritur. Nuk është zbatuar ekonomia e shkallës, ka dështuar, se kjo ishte arsyeja që u bashkua fshati me qytetin, meqenëse e tha zoti Mazniku pa mikrofon. Dhe ajo që tha zoti Mziu është zgjidhja e parë, ka dhe zgjidhje të dytë, ka dhe zgjidhje të tretë.

Zgjidhja e parë, kush është? Që buxheti i shtetit të japë të ardhura për bashkitë që nuk kanë mundësi, ose për të gjitha bashkitë, është modeli gjerman tani. Po taksat, a janë tonat? A paguan ai i njësisë administrative tarifë për ndriçim, për gjelbërim, për pastrim? A ndriçohet, gjelbërohet, pastrohet ai si ai i Gjirokastrës në qytet? Absolutisht jo, lekët i japin njësoj, pse mos i japi buxheti i shtetit po taksën 20%? Të gjithë e paguajmë ne, ai që e bleu Coca-Colën atje në njësinë administrative më të fundit dhe unë që e blej në Elbasan apo në Tiranë, njësoj. Po atëherë, pse këtu në Tiranë duhet të vijmë më shumë para dhe Gjirokastër më shumë dhe ke ai fshati atje, mos shkojë, mos i japi shteti, po më të ndërhyjë në mënyrë të drejtpërdrejtë, sepse themi ne i jep qeveria. Nga i jep qeveria? Ku i gjeti? Nga xhepat tona i merr qeveria, nga qytetarët e Gjirokastrës, Libohovës, nga Dropulli, nga Gëlcyrë, nga Memalia, nga Tepelena. T'jua rikthejë në një formë të tillë, po edhe është fondi i solidaritetit ose i barazimit që përcakton që mbledhet nga bashkitë më të fuqishme, se shtetas shqiptarë jemi të gjithë dhe shkon tek zonat që kanë më shumë nevojë, duke ia dhënë këtë të ardhur. Sigurisht, ai ndërton autonominë financiare, e ka shumë më të lehtë që ta bëjë një gjë të tillë dhe pjesa tjetër ju harroni, po qarku është pa kompetenca, qarku është formal dhe niveli i dytë i qeverisjes me kompetencat që mund t'i atashohen, mund të gjenerojë fonde nga projektet, pa pasur nevojë për kapacitete administrative, as Memalia, as Libohova, as Dropulli. I fiton qarku dhe jua shpërndan dhe qarku krijon kapacitetet e veta, ose i bën me prokurim, ose i bën në bashkëpunime dhe forma tjera. Pra, mos të përdorim gjysmë argumenta ose gjysmë të vërteta për t'i thënë kryetarëve të bashkive sot që bashkitë e juaja nuk duhet të ekzistojnë, se kështu është konteksti. Dhe në qoftë se ne vazhdojmë të përdorim përsëri të njëjtën metodë si të 2014-ës për të pritur rezultat të ndryshëm, kjo është absurde. Të presësh, të frenosh rënien e popullsisë, se do rrisësh përsëri territorin e bashkisë, mos pretendo që popullsia do rrijë, do largohet shërbimi, do mungojë përfaqësimi politik, se nuk do kenë përfaqësuesit, nuk do kenë. E di kush është përfaqësimi politik popullor, se nuk ka derë kujt i bjerë i ai, të shkojë. Takon ai kryetarin e bashkisë së Gjirokastrës sot, ai qytetari i njësisë administrative, kurrë as e takon. Katër vite në jetën e vet e sheh vetëm fushatë, se nuk shkon tek dera, nuk ka pritje populli. Ndryshe ishte dikur, nuk po themi, nuk kemi nostalgjinë për 373-shin, aspak nuk po themi atë. Ka pasur të mirat e veta, po më i ka pasur, por nuk jemi në këtë debat. Unë nuk dua ta bëj fare këtë debat, unë jam tek debati çfarë prodhoi 2014-a, kush ishin pritshmëritë dhe cili është rezultati. Kjo është shumë e thjeshtë dhe sot keni dy opinione. Opinioni nga maxhoranca është që ju jeni joefiçent, ndërmarrje ekonomike që dilni me humbje, ndërkohë që ju jeni ndërmarrje qytetare që duhet t'i shërbeni qytetarëve, pavarësisht bilanceve ekonomike, sepse ka forma për t'ju ndihmuar ju, ka shteti forma, kurse keni të mirë performancën. Ne duhet të interesohemi që a i shërbehet qytetarit në fund fare, a i shërbehet në mënyrë të barabartë qytetarit, që ai mos i iki ta zhvillojë ekonominë, të zhvillojë vendin. E di si është çështja, se flasim shumë për shpopullimin. Ne kemi dhe një lloj gjuhe euforike, jemi vend i pasur, po jemi i pasur vërtet, relativisht i pasur në raport me shumë vende tjera nga ana e pasurisë ujore, tokësore, nëntokësore. Ne pasurinë më të madhe e kemi pasur tek njerëzit, tek burimet njerëzore, tek rininë. Burimet njerëzore kanë qenë pasuria më e madhe e Shqipërisë. Sot ne e kemi humbur këtë burim, këtë pasuri dhe në mënyrë logjike do humbasim dhe pjesën tjetër të pasojës që sjell humbja e kësaj pasurie, edhe fuqinë ekonomike dhe fuqinë e tjera që janë rezultat i humbjes së saj. Kështu që nuk e kam me ju fare, unë kërkoj që ne si njerëz të ndërgjegjshëm t'i përdorim korrektësisht shifrat dhe të mos fusim ndërmjet tyre interpretime politike dhe pastaj të bëjmë dhe sfidën e shkencave këtu në komision, ku gjuha është tërësisht politike. Faleminderit, zonja Kumbaro, fjala për ju.

Mirela Kumbaro:

Shumë faleminderit, unë do flas shumë shkurt, sepse u abuzua jashtëzakonisht shumë me kohën dhe me fjalën. Me thënë të vërtetën, unë jam kaq shumë në territor sa rrallë ndoshta deputetë tjerë dhe për shkak të kohës time të gjatë që punoj në atë qark, po nuk dua, nuk doja fare ta ktheja as politike, asnjë gjë. Po se sa kryetari i bashkisë Gjirokastrë apo bashkisë Përmet apo bashkisë Libohovë, Tepelene me radhë janë në territor, edhe sa herë shkojnë në fshatra, këtë e tregon një proces që është i vetmi që nuk kemi çfarë t'i themi, që është ajo vota në fund të vitit, në fund të mandatit dhe që tregon se sa shkon deputeti. Dhe unë jam deputet që nuk ka fshat që nuk kam shkelur, edhe të gjithë ata kryetarët që janë aty janë kryetarë të cilët janë votuar disa herë dhe duke votuar disa herë e kanë treguar shumë mirë se sa e kanë lidhjen me territorin. Sa për kolegun tim Shehu, për gjithë shifrat që foli, e vetmja shifër në fakt zoti Shehu që është ulur në mënyrë drastike është numri i votave që merr forca juaj politike edhe ju personalisht që nuk votoni fare, sepse jeni gjithmonë kilista e mbyllur, por duke arritur rezultatin minimal historik në qark dhe duke marrë dhe këtë është edhe pjesa tjetër. Pastaj tregon se si janë politikat dhe fakti që kryetarët e bashkive flasin me shifra, kryetarët dhe nënkryetarët me shifra, me gjëra konkrete, pa bërë në asnjë moment asnjë lloj politizimi. Ndërkohë që këtu dëgjuam të gjithë deklaratat e mundshme politike, besoj janë ato që vlejnë më shumë nga të gjithë çka u tham. Për sa i përket komentit lidhur vërtetë me reformën, në fakt ma mori kolegu Mazniku mënyrën e interpretimit edhe shifrat që ishin dhe më të pasura nga çdo thojë unë lidhur me lëvizjet e popullsisë dhe se çfarë ka ndodhur në qarkun e Gjirokastrës në të shtatë bashki në harkun e 10 viteve të fundit, sikurse janë shifrat e thonë edhe kryetarët. Pjesa tjetër jemi këtu pikërisht për t'i përmirësuar, nuk jemi këtu për të thënë që çdo gjë është perfekte dhe s'kemi nevojë, ashtu sikurse fakti që duam të bëjmë reformë nuk do të thotë që gjërat janë keq. Përkundrazi, jemi në momentin e një analize të nevojshme, ku në çdo 10 vjet gjithsekush duhet të bëjë një analizë. Nëse rezulton që s'ka nevojë për reformë, kjo mund të jetë një konkluzion që mund ta nxjerrë komisioni juaj, por unë edhe zoti Shehu nuk jemi këtu për të dhënë, jemi këtu, jemi. Kështu që në këtë kontekst, ky ishte komenti që doja të bëja dhe faleminderit, po vazhdoj për debatin.

Arbjan Mazniku:

Vetëm një replikë dhe ta mbyllim këtë seancë, sepse do të...

Tritan Shehu:

Jo, nuk kam asnjë gjë.

Arbjan Mazniku:

Është Lezha që na pret qytet prej çerek ore. Do ishte mirë të bënim një çerek ore. Zoti bashkëkryetar.

Tritan Shehu:

Ja të qetësohen pak edhe... Po, kam ja një sekondë, kam diçka të vogël për replikë. Po, them të drejtën, unë nuk ulem, nuk ulem të diskutoj në ato çështje që u që hapi kolegja, sepse s'e bëj veten, them të drejtën. Por siç duket, problemi që ngrita unë, që ngjallë kaq shumë debat, ju ka djegur shumë, ju ka djegur jashtëzakonisht shumë, ju ka përvëluar, sepse ky është problemi më i madh që ka Shqipëria, boshatisja e Shqipërisë. Dhe ju donit ta mbushni Shqipërinë me të tjerë pastaj. Kjo është ajo dhe ky është thelbi i gjithçkaje, dhe prandaj pata gjithë reagimin nga të gjitha drejtimet politike, sepse është problemi më

i madhor dhe tregon, tregon pikërisht dështimin e gjithçkaje, jo vetëm të reformës territoriale, por të ekonomisë, të drejtave, të lirive, të votës, të gjithçkaje. Faleminderit.

Luçiano Boçi:

Tani, ta ndajmë pak çështjen se kush e ka kërkuar komisionin dhe reformën se anëtare e kabinetit që nuk e di, domethënë që është bërë një analizë nga qeveria dhe kërkohet një reformë, unë për herë të parë po dëgjoj. Nuk e ka kërkuar Partia Demokratike dhe keni pranuar ju, është kërkuar me iniciativë të kryeministrit, sepse reforma ka dështuar në shumë pika dhe vetë qeveria nuk e di. Ka këtë u dashka të mblidhemi ne dhe në fund dalim me konkluzionin: duhet një reformë apo jo? Po ne që e kemi shumë larg me punën dhe paskemi avancuar goxha. Sa kohë kemi që punojmë ne, apo jo? Paskemi avancuar shumë ne.

Arbjan Mazniku:

Zoti Boçi, për të bërë, besoj, fjalime përmbyllëse për të falenderuar dhe kryetarët për kohën. Ju faleminderit shumë për kohën dhe gjithë kohën që shpenzuar këtu dhe komentet dhe shqyrtimet tuaja, dhe faleminderit të gjithë anëtarëve të tjerë. Mendoj që bëjmë një 15 minutësh pushim.